# Bashkia Fier

# Plani Vendor i Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale 2026 - 2028

Forcimi i sistemeve kombëtare dhe lokale për të mbështetur integrimin efektiv socio -ekonomik të të rikthyerve në Ballkanin Perëndimor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA FIER**

**MIRATOHET**

**KRYETAR I BASHKISE**
**ARMANDO SUBASHI**

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM**
**ZV/KRYETARE**
**MIRELA PITUSHI**

# Bashkia Fier

# Plani Vendor i Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale 2026-2028

## Mars 2026

Përgatitur nga Grupi i Punës, Bashkia Fier:

Znj. Mirela Pitushi, Zv. Kryetare e Bashkisë Fier udhëhoqi Grupin e Punës të përbëre nga Z. Elvi Daka, anetare i keshillit Bashkiak, Bashkia Fier dhe specialistet Znj. Alma Guma, Z. Agron Margilaj me kryetare grupi Znj. Pranvera Çina, Drejtore e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Grupi i Punës u konsultua me përfaqësues dhe specialistë të institucioneve partnere dhe organizatave të shoqërisë civile, lista e të cilëve gjendet në aneksin e këtij dokumenti. Një mirënjohje e veçantë shkon për Z. Armando Subashi per mbeshtetjen e vazhdueshme ne kosnultimin per hartimin dhe zbatimin e Planit Vendor të Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale të Bashkisë Fier 2026 -2028.

# Përmbajtja

1. HYRJE DHE METODOLOGJIA ... 3
2. ANALIZA E SITUATËS ... 5
2.1 Korniza Ligjore ... 5
2.2 Korniza e Politikave dhe Planeve të Veprimit ... 9
2.2.1 Në Nivel Qendror ... 9
2.2.2 Institucionet përgjegjëse ... 14
2.2.2 Në Nivel Vendor ... 15
2.3 Dokumente dhe Raporte Relevante ... 16
2.4 Vlerësimi Paraprak i Nevojave ... 19
2.4.1 Të dhënat demografike dhe ekonomike bazë ... 19
2.4.2 Profili dhe karakteristikat e kategorive në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror ... 20
2.4.3 Shërbimet ekzistuese dhe shpërndarja e tyre në territorin e Bashkisë Fier ... 28
2.4.4 Financimi i shërbimeve aktuale ... 31
2.4.5 Strukturat që mbështesin apo ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë 32
Fier ... 32
2.4.6 Programet e buxhetit vendor për shërbimet e kujdesit shoqëror në Bashkinë Fier**Error! Bookmark not defined.**
2.4.7 Listën e shërbimeve shoqërore të munguara në territorin e Bashkisë Fier ... 37
2.5 Analiza SWOT ... 37
3. VIZIONI, QËLLIMET, OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET ... 40
3.1 Vizioni i Bashkisë Fier ... 40
3.2 Sfidat Kryesore ... 40
3.3 Qëllimet, Objektivat, dhe Aktivitetet ... 40
4.MONITORIMI DHE ZBATIMI ... 45
4.1 Treguesit e Monitorimit ... 45
4.1.1 Treguesit e monitorimit në nivel qëllimesh ... 46
4.1.2 Treguesit dhe synimet e kostuara në nivel aktivitetesh ... 47
4.2 Risqet e zbatimit ... 54
Referencat ... 55
Anekset ... 58

# 1. HYRJE DHE METODOLOGJIA

Në Shqipëri, programet e mbrojtjes sociale financohen kryesisht nga fondet qeveritare dhe të bashkive, duke synuar mbrojtjen e qytetarëve, familjeve dhe komuniteteve më të rrezikuar. Programet kryesore të tanishme përfshijnë ndihmën ekonomike (NE) dhe mbështetjen për personat me aftësi të kufizuara (PAK), të cilat janë të domosdoshme për familjet në vështirësi dhe individët që hasin sfida të veçanta. Skema e Pensioneve siguron një burim të qëndrueshëm të ardhurash për të moshuarit, ndërsa Kujdesi dhe Sigurimi Shëndetësor mbulon shpenzimet e trajtimeve mjekësore për të gjithë popullsinë. Përveç kësaj, programet si Pagesa e Barrëlindjes dhe Bonusi i Bebes synojnë mbështetjen e familjeve të e reja dhe inkurajimin e lindjeve, duke ofruar ndihmë financiare për gratë gjatë periudhës së shtatzënisë dhe pas lindjes së fëmijës. Pagesa e Papunësisë mundëson ndihmë të përkohshme për ish të punësuarit të cilët kanë humbur vendin e punës, ndërsa shërbimet e kujdesit social, qoftë ditore apo rezidenciale, mbështesin individët që kanë nevojë për kujdes të specializuar dhe të vazhdueshëm.

Bashkia Fier nisi procesin për hartimin e Planit Vendor të Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale (PVKPS) 2026-2028. Hartimi i PVKPS është një detyrim ligjor i cili buron nga Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe Ligji nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror" si dhe VKM-të përkatëse. Miratimi i tij është kusht për aksesimin e Fondit Social Qendor, i cili administrohet nga MSHMS. PVKPS bazohet kryesisht tek Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale, duke përfshirë fushat ngushtësisht të lidhura me shërbimet e kujdesit social që synojnë fuqizimin social-ekonomik të grupeve në nevojë, duke përfshirë lehtësimin e aksesit në shërbimet arsimore, strehimin social, shërbimet e punësimit dhe aftësimit, shërbimet ligjore falas, etj. Fokusi tek shërbimet orientohet drejt një qasjese të targetuar ndaj individëve, familjeve, dhe komuniteteve në nevojë për shërbime të kujdesit dhe përfshirjes sociale, duke përfshirë të rikthyerit nga proceset azilkërkuese dhe komunitetet rome dhe egjiptiane. Gjithashtu, Plani synon edhe ngritjen dhe shpërndarjen e shërbimeve edhe në nivel njësie administrative, sidomos ato jashtë qytetit të Fierit, për t'iu përgjigjur nevojave të komunitetit, aty ku ai jeton, përfshirë ndërtimin dhe vëniën në funksionim të plotë të qendrave multifunksionale komunitare në varësinë e bashkisë, të cilat të ofrojnë shërbime të larmishme për të gjitha kategoritë vulnerabël të identifikuara.

Grupi i Punës për hartimin e PVKPS është ngritur me urdhër të Kryetarit së Bashkisë Fier, dhe përbëhet nga drejtues dhe specialistë të strukturave përgjegjëse për shërbimet sociale, zhvillimin e projekteve, financat, qendrat komunitare, dhe informimin publik. Procesi i konsultimit përfshiu takime dhe tryeza konsultative me specialistë të Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve Sociale, si dhe me specialistë nga prefektura dhe drejtori të tjera rajonale përgjegjëse për arsimin, aftësimin dhe punësimin, shërbimet shëndetësore, ndihmën ligjore falas, si dhe përfaqësues të organizatave që operojnë në territorin e Bashkisë Fier.

Grupi i punës në koordinim me Pikat Fokale në institucionet dhe organizatat partnere do të jetë përgjegjës në vijimësi për përgatitjen e raporteve vjetore të zbatimit të PVKPS, të cilat i paraqiten për miratim Komitetit Drejtues për ndjekjen e zbatimit dhe monitorimin e këtij plani.

Komiteti Drejtues Ndërinstitucional propozohet të bashkë-koordinohet nga Bashkia Fier dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit Shtetëror Social. Në përbërje të këtij Komiteti do të jenë titullarët e institucioneve

bashkëpërgjegjëse. Kjo strukturë ndërinstitucionale propozohet të mblidhet të paktën një herë në vit për tu njohur me ecurinë e zbatimit të planit dhe për të dhënë rekomandime lidhur me vijimësinë.

Për t'i paraprirë procesit të hartimit të PVKPS, së bashku me metodologjinë është përgatitur edhe një vlerësim i situatës së grupeve në nevojë dhe gjendjes së shërbimeve të kujdesi shoqëror në Bashkinë Fier.

Metodologjia e zbatuar për hartimin e planit përfshiu katër faza të tilla si përgatitja e procesit, identifikimi i problemeve dhe çështjeve kritike, hartimi dhe konsultimi i planit vendor të kujdesit dhe përfshirjes sociale (PVKPS), si dhe prezantimi dhe vënia në zbatim e planit. Në mënyrë të përmbledhur më poshtë përshkruhen aktivitetet e ndërmarra për çdo fazë.

**Hapi i Parë: Përgatitja e procesit**

- Takime paraprake me grupin e punes te ngritur me urdher te kryetarit te bashkise dhe propozimi per perfshirjen e perfaqesuesve te tjere te institucioneve lokale
- *Përcaktimi i palëvë të interesuara për pjesëmarrje* në procesin e hartimit të PVKPS (përfshirë strukturat përgjegjëse në prefekturë, drejtoritë/zyrat rajonale përgjegjëse për arsimin, shëndetësinë, aftësimin dhe punësimin, ndihmën ligjore falas), organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në Fier, projekte/programe të agjencive zhvillimore apo donatore.
- *Rishikimi i planit te vjeter te Bashkise Fier dhe shfuqizimi i tij*
- Sigurimi i mbështetjes nga drejtuesit e Bashkisë Fier
- Hartimi dhe konsultimi i metodologjisë, listës së aktorëve të interesuar dhe planit të punës

**Hapi i Dytë: Identifikimi i problemeve dhe çështjeve kritike**

- Mbledhja dhe sistemi i kuadrit ligjor dhe kuadrit të politikave, dokumenteve e raporte ekzistuese.
- Analiza e kuadrit ligjor dhe kuadrit të politikave kombëtare lidhur me shërbimet sociale.
- Konsultimi i dokumenteve dhe raporteve kryesore mbi zhvillimin e shërbimeve sociale në Bashkinë Fier.
- Konsultimi me faqet e internetit Bashkia Fier,[1] Porta Vendore,[2] dhe Harta e Shërbimeve Sociale.[3]
- Konsultime me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile që operojnë në Fier.
- Konsultime me strukturat kryesore në Bashkinë Fier përfshirë ato të ofrimit të shërbimeve sociale, koordinimin e projekteve, dhe hartimin e buxhetit vendor.
- Realizimi i takimeve me institucionet dhe strukturat përgjegjëse me qëllim marrjen e informacionit dhe konsultimit mbi *grupet në nevojë* dhe *shërbimet sociale përkatëse*.
- Përgatitja e raportit të vlerësimit të situatës së grupeve në nevojë dhe gjendjes së shërbimeve të kujdesit social në Bashkinë Fier.

**Hapi i Tretë: Hartimi i Planit të Kujdesit Social në konsultim me aktorët e përfshirë**

[1] https://bashkiafier.gov.al/
[2] https://portavendore.al/bashkia-fier/
[3] https://www.sherbimisocial.gov.al/harta-e-sherbimeve-sociale-2/

- *Tryezë konsultative nr. 1* - Prezantimi i vlerësimit të situates ,objektivat e realziura nga plani i vjeter dhe mbledhja e inputeve për vizionin dhe drejtimet kryesore për përmirësimin e shërbimeve të kujdesit social ndaj grupeve në nevojë.
- Zhvillimi i vizionit, qëllimeve, rezultateve të pritshme, aktiviteteve dhe përcaktimi i institucioneve/strukturave përgjegjëse.
- Përcaktimi i treguesëve për matjen e realizimit të aktiviteteve dhe rezultateve.
- Propozimi i një mekanizmi drejtues (Komiteti Drejtues i PVKPS Fier) me titullarët e institucioneve/organizatave të përfshira për koordinimin efektiv ndërmjet aktorëve të përfshirë në hartimin e politikave dhe ofrimin e shërbimeve shoqërore.
- Dhënia e inputit strukturave përgjegjëse për kostimin e aktiviteteve.
- *Tryeze konsultative nr. 2* - Konsultimi i vizionit dhe qëllimeve, objektivave dhe aktiviteteve të PVKPS me Sektorin e Shërbimeve Sociale dhe institucionet e organizatat bashkë-përgjegjëse në Bashkinë Fier.
- Hartimi i draftit përfundimtar të Planit duke reflektuar komentet e aktorëve të përfshirë.

**Hapi i Katërt: Prezantimi dhe vënia në zbatim e PVKS**

- Tryeza Vendore për konsultimin e draft Planit Vendor të Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale (Tryeza nr. 3) – Diskutimi i plan veprimit dhe treguesëve për monitorimin e zbatimit.
- Paraqitja për aprovimi i PVKPS-së nga Këshilli Bashkiak.

Në vijimësi, **stuktura e dokumentit** përfshinë, analizën e kornizave ligjore dhe programatike, vlerësimin paraprak të nevojave për shërbime, vlerësimin e kapaciteteve të personelit përgjegjës, si dhe paraqitjen e vizionit dhe strukturës së qëllimeve, objektivave, aktiviteteve dhe treguesëve.

# 2. ANALIZA E SITUATËS

Qëllimi i kësaj analize është të identifikojë problemet dhe të orientojë gjetjen e përgjigjeve të duhura institucionale për përmirësimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe riintegrimin social të grupeve në nevojë në territorin e Bashkisë Fier.  Njekohesisht duke qene se Bashki Fier e ka nje plan social ende efektiv,i miratuar me vendim te keshilit bashiak NR 6 te dates 30.01.2024 duke u bazuar te ai plane ,eshte analizuar ne menyre te detajuar dhe cilat objektiva dhe qellime nuk jane permbushuar apo kane nevoje per ndryshim duke u bazuar te dinamika e ndryshimeve sociale ne komunitet.

Analiza e situatës përfshin përshkrimin e kornizave ligjore dhe të politikave për shërbimet sociale, si dhe përmbledhjen e gjetjeve dhe rekomandimeve në disa prej dokumenteve dhe raporteve kryesore lidhur me planet vendore sociale. Po ashtu, janë përdorur të dhëna të siguruara përmes takimeve konsultative të zhvilluara me drejtues dhe specialistë të strukturave përgjegjëse për shërbimet sociale në nivel qendror dhe vendor.

## 2.1 Korniza Ligjore

Korniza ligjore mbi kujdesin dhe përfshirjen sociale përfshin një larmishmëri ligjesh dhe vendimesh zbatuese, të cilat paraqiten më poshtë në mënyrë të përmbledhur.

**Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"**[4] në nenin 24, ndër të tjera, përcakton funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale, të cilat fokusohen veçanërisht në krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale, si dhe aplikimin në fondin social qendror dhe krijimin e fondit social vendor për financimin e këtyre shërbimeve.

**Ligj Nr. 121/2016 Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror**[5] përcakton rregullat për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Në ligj përcaktohen kategoritë e përfituesëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror (Neni 6), llojet e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe shërbimeve publike (Neni 25), strukturat përgjegjëse për administrimin dhe zbatimin e shërbimeve (Neni 31) ku përfshihen Shërbimi Social Shtetëror dhe bashkitë. Sipas ligjit, njësitë e qeverisjes vendore kanë përgjegjësinë për të planifikuar dhe buxhetuar shërbimet e përkujdesi social. Bazuar në vlerësimin e nevojave, identifikimin e burimeve financiare dhe partneritereve vendor, Bashkia harton planin vendor të kujdesit social. (Neni 36) Gjithashtu, ligji dhe aktet nënligjore[6] në zbatim të tij përcaktojnë funksionimin e Fondit Social, i cili ngrihet në nivel qëndror dhe vendor, dhe kërkojnë hartimin e planeve vendore sociale si kusht për financimin e veprimtarive që synojnë (i) përmirësimin e standardeve dhe kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror; (ii) ngritjen e shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror; (iii) zhvillimin e politikave sociale në nivel vendor. (Neni 47).

Shërbimet e kujdesit shoqëror dhe të përfshirjes sociale për kategori të veçanta rregullohen, krahas dy ligjeve të mësipërme, edhe nga ligje dhe akte nënligjore të tjera,[7] të cilat parashikojnë kategoritë e përfituesëve, llojet e shërbimeve, strukturat përgjegjëse, Fondin Social, Planet Vendore Sociale, si dhe prokurimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

- **Përfituesit**: Shërbimet e kujdesit shoqëror përfitohen pa pagesë ose përkundrejt tarifave përkatësë. Përfituesit pa pagesë të shërbimeve shoqërore përfshijnë këto kategori: (i) familjet dhe fëmijët që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare sipas legjislacionit për azilin; (ii) personat me aftësi të kufizuara; (iii) të miturit, me probleme sociale, viktimat e dhunës, trafikimit, varësisë së provuar ndaj drogës e alkoolit;(iv) vajzat shtatzëna apo prindi i vetëm i një fëmije deri në moshën njëvjeçare; (v) të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin; dhe (vi) të moshuarit në nevojë. Individi, i cili nuk përfshihet tek këto kategori përfituesish ka të drejtë, kundrejt tarifave përkatëse, të kërkojë sistemim të përkohshëm në institucionet e ofrimit të shërbimit. (Neni 6)[8]

---

[4] Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

[5] Ligji Nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror".

[6] VKM 111/2016, VKM nr. 150 datë 20.03.2019; VKM nr. 768 datë 15.12.2021 "Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik si edhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre

[7] Ligji Nr. 10221/2010, ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020 Për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Ligj Nr. 18/2017 Për Mbrojtjen e Fëmijëve, dhe VKM-të zbatuese; Ligji Nr. 37/2027 Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, dhe VKM-të zbatuese; Ligj Nr. 93/2014 Për pëfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, VKM-të zbatuese; Ligj Nr. 47/2018 dhe Ligji 125/2020 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.9669/datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrdhëniet familjare, VKM-të dhe Udhëzimet zbatuese; Ligj Nr. 111/2017 Për ndihmën juridike të garantuar nga shtetit, dhe VKM-të zbatuese; Ligj Nr. 22/2018 Për strehimin social, (i ndryshuar) dhe VKM-të zbatuese; Ligj Nr. 15/2019 Për nxitjen e punësimit; Ligj Nr. 57/2019 Për asistencën sociale; Ligj Nr. 65/2016 Për ndërmjarrjen sociale; Ligji 75/2019 Për rininë.

[8] Ligj Nr. 121/2016 Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë. Krahas këtyre kategorive, lista e përfituesëve të shërbimeve plotësohet edhe me ato të përcaktuara në (a) planet kombëtare të veprimit, si dhe vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sic janë pikat rome dhe egjiptiane, të rikthyerit nga emigracioni/përpjekjet për të kërkuar azil në vende të tjera.

- **Llojet e shërbimeve**: Ligji përmend dy lloje shërbimesh që përfshijnë (a) shërbimet shoqërore dhe (b) shërbimet publike. ***Shërbimet shoqërore*** përfshijnë; (i) shërbimet parashoqërore; (ii) shërbimet në qendrat komunitare, përfshirë dhe qendrat e zhvillimit, (iii) shërbimet shoqërore në situatë emergjence; (iv) shërbimet e kujdesit alternative për fëmijët pa kujdes prindëror;(v) shërbimet e specializuara, dhe (vi) shërbimin e këshillimit me telefon ose on-line. Nenet 8 – 24 të ligjit 121/2016 përcaktojnë më tej secilën prej këtyre kategorive. Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror përfitojnë gjithashtu ***shërbimet publike***, si arsimimi dhe shëndetësia, të cilat mbulohen nga shteti. Kontributi në fondin e sigurimeve të detyrueshme shëndetësore për këto kategori paguhet nga Buxheti i Shtetit. (Neni 25)

- **Strukturat përgjegjëse: Përgjegjësia për zbatimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror** të cilat financohen nga Buxheti i Shtetit dhe buxhetet e njësive vendore u takon ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale dhe institucionet e saj të varësisë, qarkut, dhe bashkisë. ***Ministria*** organizon dhe administron sistemin e shërbimeve sociale të kujdesit shoqëror, ndër të tjera, duke përcaktuar standardet minimale të ofrimit të shërbimit, hartuar dokumente bashkëpunimi mes aktorëve të pëfshirë në zbatimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror për të koordinuar bashkëpunimin efektiv, programon dhe u delegon fonde bashive si transfertë në fondin social, këshillon dhe udhëzon njësitë e qeverisjes vendore lidhur me strukturat që duhen ngritur prej tyre për zbatimin e sistemit të shërbimee shoqërore. (Neni 31); ***Shërbimi Social Shtetëror*** monitoron zbatimin e legjislacionit të shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin, nëpërmjet strukturave të njësisë qendore dhe drejtorive rajonale. Ndër të tjera, SHSSH harton domumentacionin tip, kryen vlerësimin e nevojave të shërbimeve të kujdesit shoqëror, harton raportin vjetor të vlerësimit, trajnon personelin e njësive të qeverisjes vendore, bashkërendon procesin e hartimit të planeve sociale, duke siguruar që këto plane të përputhen me strategjitë kombëtare. (Neni 33); ***Inspektoriati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror*** kontrollon zbatimin e kritereve e të kushteve nga subjektet publike dhe jopublike që ushtrojnë veprimtari të ofrimit të shërbimeve shoqërore. (Neni 35); ***Bashkia*** ofron dhe administron shërbimet e kujdesit shoqëror brenda territorit të saj ndër të tjera, duke hartuar planin social vendor, programuar buxhetet vendore, planifikuar shportën bazë të shërbimeve shoqërore, kontraktuar ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, dhe bashkërendurar me SHSSH shërbimet e nevojshme. Krahas strukturës së posaçme për shërbimet shoqërore, bashkia ngre njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit dhe cakton nga një punonjës social për 6-10 mijë banorë. Zyrat rajonale të SHSSH orientojnë dhe mbështesin bashkitë me numër popullsie më pak se 6 mijë banorë. (Neni 36); Ligji gjithashtu ngarkon ***Këshillin e Qarkut*** me hartimin e planit social rajonal të bashkërenduar me planet sociale të njësive të qeverisjes vendore dhe ia paraqet ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale.

- **Fondi Social[9]:** Sipas Nenit 47 të ligjit 121/2016 "Bashkia, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, krijon dhe administron fondit social, nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje

---

[9] VKM nr.111/2016 parashikon krijimin e Fondit social si një mekanizëm financiar vetëm në nivel qëndror për mbështetjen financiare të NJVQV. Fondi Social mund të ofrohet vetëm për përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, planifikimin e krijimin e shërbimeve të reja, si dhe zhvillimin e politikave sociale. Bashkitë duhet të vlerësojnë çdo vit nevojat për mbështetjen financiare nga Fondi Social. Bashkitë duhet të paktën të planifikojnë vazhdimin e ofrimit të shërbimeve që kanë ofruar në tre vitet e fundit dhe mund të delegojnë ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror tek OJF bazuar në rregullat e prokurimit të shërbimeve publike dhe lidhjes së kontratave të ofrimit të shërbimeve.

financiare për njësitë e qeverisjes vendore." Në kuptim të këtij neni, Bashkitë janë të detyruara që kërkesat për financim nga Fondi Social t'i bazojnë në tre drejtime kryesore: (i) **përmirësimin e standardeve dhe kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror**; (ii) **ngritjen e shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror**; (iii) **zhvillimin e politikave sociale në nivel vendor**. Ndonëse dy drejtimet e para lidhen ngushtësisht me shërbimet e kujdesit shoqëror, drejtimi i tretë përmbledh të gjitha politikat sociale në nivel vendor në një kuptim më të gjerë.[10] Bazuar në pikën 2 të Nenit 47, Fondi social përbëhet nga: a) të ardhurat vjetore nga Buxheti i Shtetit; b) financime jashtëbuxhetore nga organizata vendase apo të huaja ose persona të tjerë; c) të ardhurat nga zbatimi i tarifave për shërbime të ndryshme të kujdesit shoqëror; ç) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron ministria përgjegjëse për çështjet sociale; d) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron bashkia.

- **Planet Vendore Sociale[11]**: VKM nr. 150 datë 20.03.2019, krahas metodologjisë së financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, detajon edhe procedurat për miratimin e planeve sociale në nivel vendor, të cilat do të shërbejnë si referencë për përgatitjen e projekt-propozimeve nga ana e Bashkive lidhur me kërkesat për financim përmes Fondit Social. Neni 4 i saj parashikon listën e të dhënave në kuadër të të cilave bazohet analiza dhe vlerësimi paraprak i nevojave që do të shërbejnë për hartimin e planit social nga NJVV. Bazuar në këtë Nen, NJVV duhet të hartojnë planet sociale bazuar në vlerësimin paraprak të të dhënave të poshtëlistuara: a) Të dhënat demografike bazë; b) Profilin dhe karakteristikat e kategorive në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror; c) Shërbimet ekzistuese në territorin e bashkisë ose në qarkun ku bën pjesë bashkia përkatëse; ç) Listën e shërbimeve dhe shpërndarjen e tyre në territor; d) Financimin e shërbimeve aktuale; e) Të dhënat për strukturat që mbështesin apo ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror të ngritura në bashki dhe njësi administrative, në përputhje me ligjin; ë) Të dhëna krahasuese për buxhetin e bashkisë për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe shpërndarjen e tij në territorin e bashkisë; f) Listën e shërbimeve shoqërore të munguara në territor. **VKM 150/2019 kërkon që njësitë e vetqeverisjes vendore të kenë të miratuara planet sociale vendore si kusht për përfitimin e fondeve të mekanizmit të financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.** Planet sociale miratohen për periudha tre vjeçare nga Këshilli i Bashkisë dhe përfshijnë shërbimet shoqërore ekzistuese dhe shërbimet e reja të kostuara, sipas standardeve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe burimet përkatëse të financimit të tyre. Për atë pjesë të planit social i cili mbetet i pambuluar nga buxheti i Bashkisë, Këshilli Bashkiak miraton, brenda muajit shkurt të çdo viti nevojat lidhur me kërkesat për mbështetje financiare nga buxheti i shtetit. Sipas VKM nr. 150/2019, Bashkitë hartojnë brenda tremujorit të parë të çdo viti kërkesat për financim nga Fondi Social të cilat iu dërgohen MSHMS së bashku me planet sociale vendore. Megjithatë, praktika e ndjekur nga MSHMS deri tani ka qënë përmes Thirrjeve për aplikim drejtuar Bashkive të vendit. Në planin praktik, për shkak të vonesave në shpalljen e thirrjeve ose kërkesave të tjera të specifikuara përmes Thirrjeve, Bashkitë kanë gjetur vështirësi lidhur me aplikimin dhe përfitimin nga fondi social.[11] Në këtë VKM parashikohet gjithashtu edhe **lista e kritereve mbi të cilat bazohet shpërndarja e fondeve buxhetore për financimin e Fondit Social në nivel vendor**. Në mënyrë specifike këto kritere lidhen

[10] Së fundmi ka patur sugjerime për rishikimin e kësaj dispozite duke e kufizuar përdorimin e fondit social në dy drejtimet e para. Shih Raportin analitik 'Kuadri ligjor dhe sfidat e fondit social' UNDP 2023, Faqe 7. [11] VKM nr. 150 datë 20.03.2019.
[11] Shih raportin analitik, UNDP 2023, faqe 10.

me: a) kriterin e nevojës më të madhe; b) impaktin dhe prioritetet e çdo njësie të qeverisjes vendore në ofrimin e këtyre shërbimeve sipas planeve përkatëse sociale; c) mundësitë e financimit nga buxheti i shtetit; ç) shkallën e mbulimit të financimit të Fondit Social nga burime të tjera nga buxheti i shtetit; d) *qëndrueshmërinë financiare të modelit të financimit të shërbimeve*.[12] Edhe pse VKM 150/2019 parashikon gjithashtu edhe mënyrën e financimit nga Fondi Social të kërkesave të ardhura në nivel qarku, përfshirja e këtij të fundit nuk është qartësuar.

- **Prokurimi i ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror**: Rregullat e detajuara të prokurimit publik të shërbimeve të kujdesit shoqëror bazohen në **VKM nr. 768 datë 15.12.2021** "Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik si edhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre". Bazuar në Nenin 3 "kontrata të rezervuara për shërbime të caktuara" NJVQV në cilësinë e autoritetit kontraktues, mund t'i rezervojnë të drejtën e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik organizatave të caktuara për dhënien e kontratave publike për shërbime të veçanta të kujdesit shoqëror.

## 2.2 Korniza e Politikave dhe Planeve të Veprimit

Kujdesi dhe përfshirja sociale në Shqipëri përmban një numër të larmishëm strategjish, dokumente politikash ose plane veprimi në nivel qendror dhe atë vndore, të cilat paraqiten më poshtë në mënyrë të përmbledhur.

### 2.2.1 Në Nivel Qendror

**Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030** synon të sigurojë shërbime publike të nevojshme, të luftojë varfërinë, të promovojë punësimin, të forcojë sistemin e mbrojtjes sociale dhe të mbështesë segmente të veçanta të shoqërisë në nevojë. Një nga drejtimet e Mbrojtjes Sociale nën kolonën e Bashkëpunimit Social është Zhvillimi i Shërbimeve Sociale të Integruara.[14]

**Planifikimi Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2024-2026** në Kapitullin 19 fokusohet tek "Politikat Sociale dhe Punësimi" dhe përfshin masa për mundësi të barabarta dhe kundër-diskriminim, përfshirje sociale, mbrojtje sociale, aftësi të kufizuara dhe mundësi punësimi. Ky kapitulli nënvizon një qasje të fokusuar në decentralizim dhe zhvillimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe komunitar të integruara për të gjitha kategoritë e prekshme. Kapitulli 23 "Drejtësi dhe të Drejtat Themelore" thekson nevojën për zgjerimin e rrjetit të shërbimeve të integruara të kujdesit shoqëror me qëllim trajnimin profesional dhe punësimin për grupet më pak të favorizuara (përfituesit e ndihmës ekonomike, persona me aftësi të kufizuara, gra të abuzuara, individë LGBTI+, anëtarë të komuniteteve rome dhe egjiptiane, etj.). Kapitulli 28 - "Shëndetësia dhe Mbrojtja e Konsumatorit" thekson nevojën për të siguruar qasje të barabartë në shërbime sociale dhe shëndetësore të integruara cilësore për grupet e prekshme, duke përfshirë pakicat rome dhe egjiptiane, të moshuarit, personat me çështje të shëndetit mendor, personat me aftësi të kufizuara, popullsitë rurale, ata që jetojnë në zona të largëta dhe veçanërisht gra dhe vajza që i përkasin grupeve, të cilat shpesh ndeshen me forma të ndryshme të diskriminimit.[13]

---

[12] Për një analizë vlerësuese të këtyre kritereve shih raportin analitik UNDP 2023, faqe 11. [14]
VKM Nr. 80, datë 22.02.2023, "Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim".
[13] VKM Nr. 91, datë 9.02.2022, "Plani Kombëtar për Integrimin Kombëtar 2022-2024," https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/02/09/91.

**Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030** dhe Plani i Veprimit i saj ndër të tjera parashikon rritjen dhe përmirësimin e shërbimeve të specializuara për viktimat e sulmit seksual dhe trafikimin për qëllime shfrytëzimi seksual nga të gjitha grupet; rritjen/përmiresimin e shërbimeve të specializuara për strehim emergjent; rritjen/përmiresimin e shërbimeve të specializuara për strehimin afatgjatë; mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse që ofrojnë forma të ndryshme të shërbimeve të specializuara për raste të dhunës gjinore, dhunës në familje dhe trafikim. [14]

**Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Lokale 2023-2030**, ndër të tjera, fokusohet në sigurimin e shërbimeve lokale cilësore sipas standardeve kombëtare, shoqëruar nga rritja e performancës së bashkive dhe menaxhimit të burimeve njerëzore. Disa nga objektivat janë: konsolidimi i rolit të Njësive të Vetqeverisjes Vendore në ushtrimin e funksioneve të tyre duke sqaruar zbrazësitë ligjore, institucionale dhe mekanizmat e financimit në marrëdhëniet ndërqeveritare; përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në nivel lokal, i ndjekur nga ndërtimi i kapaciteteve lokale administrative për të përmirësuar sigurimin e shërbimeve publike; përmirësimi i efikasitetit të shërbimeve, përmirësimi i performancës së qeverisjes lokale. Kjo strategji vendos shifra specifike të lidhura me përmirësimin e shërbimeve sociale në nivel lokal përmes financimit nga Fondi Social. [15]

**Strategjia për Zhvillimin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor në Shqipëri 2021-2030**
Objektivi Specifik 6 i Qëllimit të Politikës I: Përmirësimi i programeve mbështetëse socio
-shëndetësore (integruese) të shëndetit mendor, si dhe burimeve dhe kapaciteteve për
zbulimin e hershëm dhe ndërhyrjet për crregullimet e shëndetit mendor
**Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029**, në politikën nr. 3 thekson përfshirjen e të rinjve që janë në një situatë të rrezikut ose përjashtim shoqëror në aktivitete që synojnë mirëqenien aktive, të shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore, sigurinë, mbrojtjen dhe pjesëmarrjen e rinisë në të gjitha fushat e jetës.[24]
**Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026** vizionon një sistem arsimor cilësor bazuar në parimet e përfshirjes dhe mësimin gjatë tërë jetës, që mundëson zhvillimin e potencialit të individit, duke kontribuar në mirëqenien e tij personale, si dhe forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian. Strategjia vendos theksit tek rritja e bashkëpunimit me strukturat arsimore për shkëmbimin reciprok të informacionit mbi fëmijët e moshës parashkollore dhe shkollore, me qëllim vlerësimin e saktë të aftësive në përputhje me grupmoshën, si dhe për të siguruar identifikimin dhe plotësimin e nevojave të tyre të trajnimit, brenda kornizës së sistemit të arsimit të përgjithshëm dhe atij të arsimit të veçantë.[16] **Strategjia e Përgjithshme e Drejtësisë për të Mitur (2022-2026)** synon të forcojë dhe konsolidojë arritjet në fushën e drejtësisë penale për të mitur, qasjen tek drejtësia restauruse, me qëllim të mbajtjes së tyre larg riangazhimit në kriminalitet dhe viktimizimit të tyre, në mënyrë që çdo fëmijë të ketë gjithmonë akses në një sistem miqësor për rikthimin e të drejtave të shkelura në fushën familjare, civile, administrative dhe penale. Një numër masash në këtë strategji lidhen me funksionet e pushtetit vendor në sigurimin e shërbimeve parandaluese dhe reintegruese për të miturit dhe të rinjtë në kontakt me ligjin.[17]

---

[14] https://shendetesia.gov.al/sp-content/uploads/2021/07/Strategjia-Kombetare-per-Barazine-Gjinore-2021-2030.docx.
[15] https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_567_SKNDQV-2023-2030.pdf
[16] VKM nr 621, date 22.10.2021, " Strategjia Kombëtare e Arsimit dhe Plani I Veprimit 2021-2026 "
[17] Strategjia e Përgjithshme e Drejtësisë për të Mitur (2022-2026).

**Plani Kombëtar i Veprimit kundër Trafikimit të Njerëzve (2024-2025)** Ky dokument është vazhdim i përpjekjeve dhe objektivave antitrafikim të parashikuara në Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021–2023, por të përshtatura me ndryshimet dinamike të formave dhe tendencave të trafikimit, vizionit të qeverisë, reformave të ndërmarra në fushën e antitrafikut si dhe detyrimeve në kuader të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, proceseve rajonale dhe ndërkombëtar dhe ka misioni të promovojë një përgjigje efektive, adekuate dhe të koordinuar ndaj parandalimit dhe luftës kundër trafikimit të njerëzve, bazuar në bashkëpunimin ndërkombëtar, bashkëpunimin efektiv ndër-institucional brenda vendit, pjesëmarrjen e viktimave/potencialëve të trafikimit dhe angazhimin e shoqërisë civile dhe komunitetit.

**Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve (2021-2026)** ka një ndërlidhje të rëndësishme me strategjinë e mbrojtjes sociale të fokusuar në krijimin e një sistemi mbrojtës social që përqendrohet në fëmijën dhe trajtimin në gjithë ciklin e jetës, si dhe fokusin në procesin e dezinstitucionalizimit të sistemit të kujdesit rezidencial për fëmijë.[18]

**Strategjia Kombëtare për Reduktimin e Rrezikut nga Katastrofat 2023-2030** përcakton objektivat dhe veprimet e formalizuara për reduktimin e rrezikut nga katastrofat dhe cakton drejtimin strategjik për zhvillimet e mëtejshme të sistemit kombëtar. Strategjia i kushton vëmendje të veçantë adresimit të nevojave të grupeve të ndjeshme dhe të marginalizuara.[19]

**Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030** identifikon sfidat e sektorit të punësimit dhe aftësive duke u përqendruar tëk zhvillimi i aftësive, tregu i punës, dhe cilësia e punës. (faqe 4-13) Dokumenti gjithashtu analizon politikat aktuale të tregut të punës dhe sfidat institucionale lidhur me ndërmjetësimin në tregun e punës, programet e nxitjes së punësimit, arsimimi dhe formimi profesional, inspektimi në punë, partneriteti social, rregullat e hyrjes dhe daljes nga puna, paga minimale, dhe pagesa e papunësisë. (faqe 14 – 28). Strategjia përcakton dy qëllime kryesore: zhvillimin e aftësive dhe forcimi i lidhjes me tregun e punës, dhe mundësimi i punësimit të denjë për gra dhe burra nëpërmjet politikave gjithëpërfshirëse.[20]

**Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024 – 2030** synon të përqendrohet në migracionin e rregullt dhe rikthimin vullnetar të emigrantëve shqiptarë nga vendet e BE-së. Nëpërmjet kësaj strategjie synohet të nxitet bashkëpunimin ndërkombëtar dhe forcimi i mekanizmave për rikthimin dhe riintegrimin e personave të kthyer. Projekti fokusohet në informimin e emigrantëve rreth mundësive të tregut të punës në Shqipëri, promovimin e kanaleve formale për dërgesat dhe luftën kundër informalitetit. Synimi kryesor është parandalimi i migracionit të parregullt dhe përmirësimi i mekanizmave institucionalë deri në vitin 2026. Kostoja e parashikuar për këtë plan është rreth 727.9 milionë lekë për tre vitet e para, me shpenzime të planifikuara prej rreth 391.8 milionë lekësh për periudhën 2024-2026, të përfshira në buxhetet vjetore dhe Programin Buxhetor Afatmesëm. [21]

---

[18] Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve (2021-2026).
[19] Strategjia Kombëtare për Reduktimin e Rrezikut nga Katastrofat 2023-2030.
[20] Strategjia Kombëtare e Punësimt dhe Aftësive 2023 – 2030, https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/561
[21] Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024 – 2030.

**Strategjia e Strehimit Social 2016 – 2025** ka si qëllim kryesor ofrimin e zgjidhjeve të gatshme, të arritshme, të përballueshme dhe cilësore për strehim për familjet me të ardhura të ulëta dhe të mesme që nuk mund të përballojnë një shtëpi në treg të hapur dhe, në veçanti, për familjet me tregues të pozitave të pafavorizuara që çojnë në përjashtim nga strehimi. Objektivat e strategjisë janë kategorizuar sipas katër drejtimeve strategjike, të cilat përfshijnë (1) sigurimin e evidencës rreth strehimit social dhe kapaciteteve vendore; (2) përmirësimin e kuadrit ligjor, institucional, dhe rregullator; (3) fuqizimin e instrumenteve financiare për grupet në pozita të pafavorizuara; dhe (4) zgjerimin dhe riorientimin e programeve të strehimit social.[22]

**Reforma e Mbrotjes Sociale**

**Strategjia e Mbrojtes Sociale** basohet tek **reformimi i mbrojtjes sociale** dhe pëfshin reformimin e ndihmën ekonomike dhe përfitimeve të tjera, reformimin e aftësisë së kufizuar, si dhe shërbimeve të kujdesit social. Me zbatimin e Strategjive për Mbrojtjen Sociale 2015-2020-2023, Shqipëria ka përparuar me reformën e sistemit të shërbimeve sociale, duke zhvilluar një qasje të integruar dhe të decentralizuar në ofrimin e kujdesit social, në mbështetje të skemave të reformuara të ndihmës sociale (përkatësisht, Ndihma Ekonomike dhe Aftësia e Kufizuar), si dhe në funksion të fuqizimit të individit dhe familjes gjatë ciklit të jetës, për tejkalimin e situatave të përjashtimit social dhe rintegrimin. Në vitet e fundit, zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social në vend është udhëhequr nga tre parime themelore, që përfshijnë ***deinstitucionalizimin***, ***diversifikimin*** dhe ***decentralizimin***. Instrumentet kryesore në mbështetje të këtyre reformave janë (i) angazhimi në punët publike; (ii) garancia për të rinjtë; (iii) fondi për punësimin social; (iv) fondi social kombëtar; (v) ndërmarrjet sociale.[23]

**Angazhimi në punët publike.** Përmes angazhimit në punët publike të personave përfitues të ndihmës ekonomike të aftë për punë synohet fuqizimi I individit dhe dalja graduale nga skema e ndihmës ekonomike.[24]

**Garancia për të rinjtë**. Parimi i katërt i Shtyllës Evropiane të të Drejtave Sociale thekson të drejtën e çdo qytetari të BE-së për mbështetje kohore dhe të përshtatur për punësim, me qëllim të avancimit të perspektivave për punësim ose punësim në vetëpunësim. Sipas këtij parimi, të rinjve prej 2024 u garantohet e drejta për të ndjekur arsimin e mëtejmë, marrë trajnim, ose për të siguruar punë brenda katër muajve nga momenti kur bëhen të papunë ose largohen nga arsimimi. Ky angazhim përfshin ofrimin e një oferte të përshtatshme për punë, trajnim, ose arsim për çdo individ nën moshën 29 vjeç në një kohë të arsyeshme pas identifikimit. Për të bërë këtë të mundur, është zhvilluar një plan kombëtar për zbatimin e Garancisë për të Rinjtë në bashkëpunim me ministritë relevante.[25]

**Fondi për Punësimin Social**. Në vitin 2019, Ligji për Promovimin e Punësimit parashikoi themelimin e Fondit për Punësimin Social me qëllim ofrimin dhe administrimin e mekanizmave financiare për të promovuar punësimin, integrimin dhe përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara. Fondi i Punësimit Social do të financohet nga punëdhënësit, si dhe nga kontributet e tjera, duke përfshirë donacionet. Do të menaxhohet nga AKPA për të financuar programe të punësimit, trajnimit, punësimin

---

[22] Strategjia e Stehimit Social 2016-2025, https://infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/VKM_nr_405_date_1.06.2016.pdf ; shih edhe Raportin e Vlerësimit, 2020.
[23] Shih, Strategjinë për Mbrojtjen Sociale 2024-2030.
[24] Po aty.
[25] Po aty.

në vetëpunësi, dhe përshtatjet e vendeve të punës për individët me aftësi të kufizuara, si dhe përfshirjen në programe të nxitura për punësimin në shtëpitë e personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi kryesor është nxitja e një kulturë përfshirjeje në vendin e punës si dhe institucionet e aftësimit dhe edukimit.[26]

**Fondi Social Kombëtar**. Fondi Social për financimin e krijimit të shërbimeve sociale të reja ose konsolidimit të atyre ekzistuese, si pjesë e fondit social lokal, u miratua për herë të parë në vitin 2016. Fondi Social është një instrument financiar kritik, dhe përdorimi i tij efektiv varet nga gatishmëria e njësive të qeverisë lokale për të zbatuar funksionet e tyre në lidhje me sigurimin e shërbimeve sociale. Fondi Social për financimin e shërbimeve sociale u bë operacional për herë të parë në dhjetor 2019, me një buxhet të dedikuar të caktuar për bashkitë për themelimin e shërbimeve të kujdesit social. Synimi ishte të financoheshin shërbimet në 35 bashki deri në vitin 2023, me prioritet për ato njësi vendore që aktualisht nuk ofrojnë asnjë shërbim.

**Ndërmarrjet Sociale**. Ndërmarrjet Sociale janë një mundësi për punësimin e individëve të disavantazhuar përmes përdorimit të subvencioneve nga një fond i dedikuar për këtë qëllim, i quajtur Fondi i Ndërmarrjeve Sociale. Ligji për "Ndërmarrjet Sociale" u miratua në vitin 2016, por zbatimi i tij nisi për herë të parë në vitin 2018 bazuar në një vendim "për themelimin e fondit dhe format e mbështetjes përmes subvencioneve për mbështetjen e ndërmarrjeve sociale" dhe një udhëzim që rregullonte modalitetet e përdorimit të tyre. Aktualisht, 9 OJQ kanë fituar statusin e Ndërmarrjeve Sociale, por financimi i tyre ende nuk ka filluar. Në mars 2023, Qeveria shqiptare miratoi format e mbështetjes përmes subvencioneve për ndërmarrjet sociale për periudhën 2023-2025. Fondi i caktuar për mbështetjen e ndërmarrjeve sociale, siç është përcaktuar në pikën specifike të Programit të Mijëvjeçarit të Mesëm "Kujdesi Social" për periudhën 2023-2025, është vendosur në 240,000,000 (dyqind e katërzet milion) LEK.[27]

**Dimensioni gjinor**. Puna dhe kujdesi i papaguar, martesat e hershme, dhuna në familje, dhe nevoja për mbrojtjen e fëmijës dhë nënës janë gjithashtu faktorë të rëndësishëm lidhur me mbrojtjen sociale. ***Për të kompensuar punën e papaguar të grave***, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MoHSP) ka lëshuar një udhëzim që specifikon se gratë të papuna me tre ose më shumë fëmijë, në moshë deri në 18 vjeç, ku njëri prej tyre është nën moshën 5 vjeç, dhe familja siguron të ardhura bruto prej më pak se 100,000 ALL në muaj - duke i vendosur ato në kategorinë e papunësisë ekonomike - kanë të drejtë për mbulim nën skemën e detyrueshme të sigurisë sociale dhe shëndetësore. Pagesa e kontributeve të tyre financohet nga buxheti i shtetit, duke mbuluar periudhën e kujdesit të fëmijës deri në moshën 5 vjeç.[38] ***Martesat e hershme***. Rreziku i ndërprerjes së shkollës, për shkak të përgjegjësive në shtëpi, detyrave shtëpiake, detyrave të kujdesit, si dhe presioneve për tu martuar në moshë të re (posaçërisht për vajzat) dhe për të mbështetur jetesën e familjes (posaçërisht për djemtë dhe në disa kontekste, vajzat), është një sfidë e rëndë për shumë adoleshentë. Vlen të theksohet se në Shqipëri ka pasuar një progres në përmirësimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin efektiv të kornizës ligjore dhe politikave që rregullojnë të drejtat e fëmijëve. Praktika e martesave të hershme ende ekziston, kryesisht ushqyer nga pabarazia gjinore, varfëria dhe përjashtimi social. Mungesa e të dhënave zyrtare pengon reflektimin e saktë të shpërndarjes së martesave të fëmijëve. Megjithatë, është thelbësore të theksohet se ligjet që

[26] Po aty.
[27] Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2024-2030.
[38] Po aty.

synojnë mbrojtjen e adoleshentëve nga martesat e hershme nuk janë gjithmonë efektive ose të plotësisht zbatuara. Përtej kësaj, gjatë vitit 2021, qeveria për herë të parë ka prioritizuar adresimin e martesave të hershme brenda politikave të saj kombëtare të buxhetuara. Në të njëjtën kohë, axhenda kombëtare për të drejtat e fëmijëve për periudhën 2021-2026, e miratuar në vitin 2021, përfshin objektiva dhe masa për të luftuar këtë praktikë të dëmshme. [28]

***Dhuna bazuar në gjininë***. Në vitet e fundit, vendi ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt eliminimit të diskriminimit bazuar në gjinë dhe arritjes së barazisë gjinore, veçanërisht në kornizat ligjore dhe politikat. Megjithatë, sfidat dhe çështjet vazhdojnë të ekzistojnë për shkak të faktorëve historikë, shoqërorë, ekonomikë dhe kulturorë. Forma e ndërsektorëve të diskriminimit që përballen shumë gra për shkak të gjinisë dhe faktorëve tjerë (etnia, aftësia e kufizuar, orientimi seksual, moshë, situata socio-ekonomike) mbeten të paadresuara. [40]

***Mbrotja dhe kujdesi për nënën dhe fëmijën***. Mbrojtja dhe kujdesi për nënën dhe fëmijën janë të domosdoshme për ushqimin dhe shëndetin e duhur, mirëqenien e të dy nënave dhe fëmijëve të tyre, parandalimin dhe reduktimin e varfërisë dhe vulnerabilitetit, si dhe për arritjen e barazisë gjinore në tregun e punës. Në përputhje me prioritetet strategjike dhe politikat e mbështetjes të Qeverisë shqiptare, "bonusi i bebes" është vendosur që nga janari i vitit 2019 si një stimul financiar për të mbështetur familjet e reja, për të rritur numrin e lindjeve dhe për të zhvilluar shoqërinë. Nisma për ofrimin e paketave të kujdesit për fëmijët dhe nënat raportohet të jetë zbatuar me sukses, duke përfshirë edhe nënat rome dhe egjiptiane.[41]

### 2.2.2 Institucionet përgjegjëse

**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** është institucioni kryesor përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e politikave të mbrojtjes, kujdesit dhe integrimin e individëve dhe grupeve në nevojë. **Shërbimi Social Shtetëror**, në varësi të Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është një institucion përgjegjës për zbatimin e politikave të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për ndihmën ekonomike, aftësinë e kufizuar dhe shërbimet e kujdesit social.

**Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve** është institucioni përgjegjës për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve, në përputhje me politikat kombëtare në mbrojtjen e fëmijëve, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi, braktisja, keqtrajtimi dhe dhuna.

**Njësitë e Pushtetit Vendor n**ë përputhje me Reformën Territoriale të aprovuar përmes Ligjit Nr. 115/2014 "Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligjit Nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Lokale", ka përgjegjësinë për operimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë. Ndër të tjera, Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe menaxhimin e qendrave të shërbimeve sociale lokale, krijimin e një fondi shërbimesh sociale në bashkëpunim me ministritë përgjegjëse për çështjet sociale.

---

[28] European Comission 2022. Albania 2022 report; shih gjithashtu, Strategjinë e Mbrojtes Social 2024-2030. [40] UN, 2022. Common country analysis 2022, Albania; shih gjithashtu, Strategjinë e Mbrojtes Social 2024-2030

[41] Strategjia e Mbrojtes Social 2024-2030.

**Drejtoritë e Shërbimeve Sociale në nivel vendor** janë përgjegjëse për planifikimin, administrimin dhe ofrimin e ndihmës sociale dhe shërbimeve sociale në nivel vendor. Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NJVNR), Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF), koordinatorët lokal përgjegjës për dhunën në familje dhe ndaj grave dhe punonjësit e tjerë të shërbimeve sociale janë përgjegjës për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale komunitare në nivel lokal, ndërtimin dhe administrimin e qendrave komunitare për ofrimin e shërbimeve sociale lokale, si dhe krijimin e shërbimeve dhe tipologjive të ndryshme për të përgjigjur ndaj nevojave të grupmoshave të ndryshme sipas veçorive lokale.

**Institucione të tjera përgjegjëse** janë Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Inspektoriati i Punës dhe Shërbimeve Sociale[29], Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Social[30], si dhe Urdhri i Punonjësve Socialë dhe Urdhri i Psikologëve. Dy entitetet e fundin janë krijuar respektivisht përmes Ligjit 164/2014, ndryshuar në "Ligjin për Punonjësit Social në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligjit Nr. 40/2016 "Për Urdhrin e Psikologëve në Republikën e Shqipërisë" dhe janë përgjegjës për garantimin dhe sigurimin e vazhdueshëm të standardeve dhe praktikave të larta cilësore në ushtrimin e profesionit në fushën e punës sociale dhe psikologjisë, si dhe mbrojtjen e publikut nga praktika jo-profesionale dhe jo-etike e punonjësve socialë dhe psikologëve.

Njohja me kuadrin ligjor, kuadrin e politikave, strategjitë dhe planet kombëtare të veprimit lidhur me kujdesin shoqëror dhe përfshirjen sociale si dhe rolin e institucioneve përgjegjëse përmbën një pikënisje të dobishme për të identifikuar si problematikat sociale ashtu edhe përgjigjen e duhura institucionale në PVKPS në Bashkinë Fier. Për më tepër, ajo ofron një bazë të mirë informuese dhe orientuese për të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e rinj që iu bashkohen strukturave të shërbimeve sociale në nivel vendor.

### 2.2.2 Në Nivel Vendor

#### Plani i Kujdesit Social 2024-2026 Bashkia Fier

Plani i Kujdesit Social është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 6 datë 30.02.2024 dhe ndër të tjera, përfshin të dhëna lidhur me kuadrin ligjor,me situatën demografike, ekonomike, punësimin dhe papunësinë, arsimin dhe kujdesin shëndëtësor.[31] Gjithashtu, në dokument ofrohen një analizë e kapaciteteve institucionale, njerëzore dhe financiare për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social në Bashkinë Fier. Më tej, vijon një përshkrim i nevojave sociale të grupeve në rrezik shoqëruar me analizën Plani përmban edhe katër anekse që përshkruajnë (i) situatën e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Fier, (ii) nevojat e individëve dhe grupeve për shërbime të kujdesit shoqëror, (iii) planin e monitorimit dhe vlerësimit, dhe (iv) kostimin dhe hendekun buxhetor.

Plani ndjek qasjen e ofrimit të një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë mbi bazën e partneriteteve ndërinstitucionale vendore e rajonale, organizatat ndërkombëtare dhe biznesit vendor si një mbështetës potencial i shërbimeve sociale. Ky Plan përmban katër fusha kryesore të cilat janë (i) koordinimi dhe rrjetësimi i shërbimeve; (ii) ngritja e kapaciteteve të strukturave dhe burimeve

---

[29] VKM Nr. 295/2013, "On the Establishment, Organization and Operation of the State Labor and Social Service Inspectorate".

[30] VKM Nr. 637/2021 "On the Establishment and Functioning of the Health and Social Care Quality Assurance Agency"

[31] Plani i Kujdesit Social 2019-2023 Bashkia Fier miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 51, datë 19.05.2019; shih gjithashtu, Faqen e internetit Bashkia Fier https://bashkiafier.gov.al/; Porta Vendore, https://portavendore.al/bashkia-fier/; dhe Harta e Shërbimeve, https://www.sherbimisocial.gov.al/harta-e-sherbimeve-sociale-2/

njerëzore; (iii) zhvillimi i shërbimeve sociale në Bashkinë Fier; (iv) zhvillimi i programeve parandaluese.
**Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane, Bashkia Fier, 2019 -2022**

Plani Vendor i Bashkisë Fier për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane, është një zhvillim progresiv i Planit Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, si dhe në linjë me Planin Social 2019-2022 të Bashkisë Fier.[32] Ky Plan udhëhiqet nga disa parime themelore si: (i) nxitja e përfshirjes sociale (ii) reagim ndaj situatave të vështira social-ekonomike dhe emergjente për pakicat rome dhe egjiptiane, (iii) respektimit të dallimeve midis pakicave rome dhe egjiptiane, (iv) përfshirjen e pakicave në identifikimin e nevojave dhe hartimin e masave (v) forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit midis aktorëve: bashkisë dhe institucioneve qendrore, organizatave të shoqërise civile, aktivistëve dhe grupeve komunitare. Plani krahas analizës së kuadrit ligjor dhe politik, metodologjisë së ndjekur për hartimin e tij, si dhe nevojat e vlerësuara të të dy komuniteteve rome dhe egjiptiane, përcakton gjithashtu pesë objektiva strategjike. Këto objektiva të cilat synojnë komunitetet rome dhe egjiptiane përfshijnë (i) rritjen e arsimimit, (2) fuqizimin ekonomik dhe punësimin, (3) përmirësimin e strehimit, (4) rritjen e aksesit në shërbimet shëndetësore, si dhe (5) përmirësimin e shërbimeve të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale, duke synuar ndër të tjera edhe riintegrimin e familjeve rome dhe egjiptiane të kthyera nga migrimi.

**Plani Vendor i Strehimit Social 2023 – 2028, Bashkia Fier**

Qëllimi i hartimit të programit 5-vjeçar të strehimit për Bashkinë Fier, është njohja dhe identifikimi i grupeve vulnerabël dhe nevojave të e tyre për strehim, si dhe propozimi i alternativave afatmesme për sigurimin e strehimit të përballueshëm, sipas programeve të legjislacionit përkatës.[33] Bazuar në nenin 68 të ligjit 22/2018 "Për strehimin social", strukturat përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore hartojnë programe 5-vjeçare strehimi social për popullsinë nën juridiksionin e tyre, të cilat miratohen nga këshilli bashkiak i njësisë.

**Programi Buxhetor Afatmesëm Vendor, Bashkia Fier**.

Bashkia Fier ka miratuar programin buxhetor afatmesëm vendor për periudhën kohore 2026 -2028 ku në të parashikohen shpenzimet si edhe investimet për funksione të ndryshme ndër këto edhe funksioni për mbrojtjen sociale ku përfshihet edhe mbrojtja sociale dhe strehimi Social.[34]

## 2.3 Dokumente dhe Raporte Relevante

**Raport Analitik - Kuadri ligjor dhe sfidat për funksionimin e Fondit Social në juridiksionin vendor, UNDP**
Raporti analizon kuadrin ligjor për ngritjen dhe funksionimin e fondit social dhe planeve sociale në nivel vendor.[35] Ai identifikon probleme praktike në funksionimin e fondit dhe ofron rekomandime për lehtësimin e procedurave të aplikimit dhe përfitimit të mbështetjes financiare nga fondi social në nivel bashkie. Raporti vë në dukje mungesën e dispozitave ligjore që rregullojnë ngritjen dhe funksionimin e

[32] Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane, Bashkia Fier, 2019 -2022. Plani është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 73 datë 18.06.2019.
[33] Plani Vendor i Strehimit Social 2023 – 2028, Bashkia Fier.
[34] Plani buxhetor afatmesëm miratohet në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në nenin 34 të ligjit Nr.9936, datë 28.06.2008, ku çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore. NJQV janë përgjegjëse edhe për përgatitjen e programeve buxhetore afatmesëm.
[35] Nadia Rusi, Ilir Ciko, Kuadri Ligjor dhe Sfidat për Funksionimin e Fondit Social në juridiksionin vendor: Raport Analize, UNDP, Janar 2023.

fondit social në nivel bashkie, duke theksuar nevojën për ta bërë atë funksional në të gjitha bashkitë dhe për të garantuar koordinim të qëndrueshëm në nivel qendror dhe vendor.

Raporti analitik i UNDP-së tregon se në fund të vitit 2022, rreth 85% e bashkive kishin miratuar planin social vendor për vitin 2022. Arsyet kryesore që rreth 15% e bashkive nuk e kishin miratuar planin social vendor lidhen me mungesën e kapaciteteve për përgatitjen e planit (40% e rasteve të kontaktuara) dhe problematikat në procedurën e miratimit të planit social vendor (20% e rasteve të kontaktuara). Përgatitja e planit social vendor është raportuar si një proces i vështirë nga bashkitë më të vogla për shkak të mungesës së strukturave administrative dhe problematikave specifike të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Miratimi i planit social vendor nga Këshilli Bashkiak ka qenë problematik në disa raste për shkak të mungesës së buxhetimit të planit social vendor në buxhetet e miratuara të bashkive, ndonëse miratimi i planit social vendor është një kusht për përfitimin e fondeve të mekanizmit të financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Kjo problematikë kërkon zgjidhje të qëndrueshme përmes rregullimeve ligjore.

Pothuajse 60% e bashkive të kontaktuara treguan se mungesa e kapaciteteve në strukturat e tyre ishte problemi kryesor gjatë përgatitjes së planit social vendor. Gjithashtu, vështirësitë në përllogaritjen e kostove, dinamika në ndryshim e nevojave për shërbime sociale dhe vlerësimi i tyre, si dhe mungesa e udhëzimeve të qarta mbi metodikën e përgatitjes së planit social vendor, ishin disa nga problemet e tjera të identifikuara në këtë proces.[36]

Sipas këtij raporti, mungojnë udhëzimet specifike për ngritjen dhe administrimin e fondit social si një fond i veçantë në nivel bashkie. Mungesa e udhëzimeve specifike ka rezultuar në perceptime dhe realitete të ndryshme mbi konceptin dhe funksionimin e fondit social në bashki të ndryshme. Rreth 1/4 e bashkive të kontaktuara raportuan se nuk e kanë ngritur fondin social sipas përcaktimit të Nenit 47/1 të ligjit Nr. 121/2016, për shkak të mungesës së buxhetit përkatës dhe kapaciteteve apo infrastrukturës. Në bashkitë që raportuan se kanë ngritur fondin social sipas përcaktimit të Nenit 47/1 të ligjit Nr. 121/2016 (71% e bashkive të kontaktuara), fondi social nuk ekziston si një fond i posaçëm buxhetor, por financimi përmes fondeve të financimit të shërbimeve sociale kryhet sipas programeve buxhetore ekzistuese për shërbimet sociale.

Vetëm 15% e bashkive të kontaktuara treguan se financimi për përmirësimin e standardeve dhe kapaciteteve administrative të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, krijimin e shërbimeve të reja dhe zhvillimin e politikave sociale kryhet përmes fondit social, ndërsa 38% e bashkive treguan se këto funksione kryhen përmes programeve buxhetore për financimin e këtyre shërbimeve dhe 33% përmes kombinimit të të dy formave. [37]

### Raport i Shërbimit Social Shtetëror mbi ecurinë e Planeve Sociale në Bashkitë e Qarkut Fier

Raporti analizon ecurinë e zbatimit të planeve sociale në të gjitha bashkitë e qarkut, përfshirë edhe planin social të Bashkisë Fier për vitet 2024-2026.[38] Dokumenti vë në dukje se Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Fier përbëhet nga drejtori dhe 21 punonjës, nga të cilët 4 janë diplomuar në

[36] Raporti UNDP 2023, faqe 15-16.

[37] Faqe 16. Shih gjithashtu, rekomandimet lidhur me analizën ligjore dhe funksionimin e Fondit Social, faqe 21-22.

[38] Raport mbi ecurinë e Planeve Sociale në Bashkitë e Qarkut Fier, Shërbimi Social Shterëror,

fakultetin e shkencave sociale dhe u përputhet diploma me vendin e punës. Sipas raportit, NJVNR ende nuk është ngritur, edhe pse përbën një strukturë të rëndësishme në menaxhimin e rasteve sociale dhe vlerësimin e nevojave për shërbime.

Sipas raportit, shërbimet sociale që ofrohen në Bashkinë Fier përfshijnë: Shtëpinë e të Moshuarve për të moshuarit, Qendrën Ditore të Zhvillimit "Horizont" për personat me aftësi të kufizuara dhe 1 qender komunitare për fëmijët në nevojë te mbeshtetur nga Fondi Social,Bashkia Fier dhe organizata Terre des hommes . Gjithashtu, në ambientet e Spitalit Rajonal Fier është ngritur një qendër emergjence për trajtimin e fëmijëve në rast abuzimi seksual apo në nivel risku të lartë. Pranë Bashkisë Fier funksionojnë 3 komisione ndërsektorale: Grupi Teknik Ndërsektorial (GTN) për fëmijët në nevojë për mbrojtje, Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) për dhunën në familje dhe komisioni për fëmijët me aftësi të kufizuara (PAK).

Në Bashkinë Fier vihet re një rritje të personave me nevoja sociale që kërkojnë shërbime. Aktualisht, janë 180 raste dhune në familje dhe femije ne nevoje per mbrojtje që marrin shërbime shëndetësore, shërbime ligjore falas, shërbime psikologjike, ndihmë ekonomike, referime pranë organizatave dhe ndihma me paketa ushqimore, veshëmbathje dhe artikuj shkollorë. Gjithashtu, janë rreth 500 fëmijë që po trajtohen me shërbime sociale të ndryshme, nga të cilët 75 fëmijë me aftësi të kufizuara marrin shërbime pranë Qendrës "Horizont",femije te trajtohen me mesues mbeshtetes ne shkolla,femije ne konflikt me ligjin apo femije ne nevoje per mbrotje.

Raporti inkurajon bashkinë të punojë për ngritjen e shërbimeve të reja të munguara duke aplikuar për Fond Social ose duke bashkëpunuar me donatorë dhe organizata partnere. Një pjesë e stafit social janë të rinj në vendin e punës dhe kanë nevojë për trajnime të vazhdueshme në fushën e shërbimeve sociale. Raporti rekomandon që Bashkia Fier të ngrejë sa më parë Njësinë për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimin (NJVNR) të rasteve dhe të marrë masa për më shumë trajnime për punonjësit sipas fushave që mbulojnë.

**Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Planeve Lokale Sociale:**

Më qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve lokale të mbrojtjes Sociale, UNDP dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kanë zhvilluar një metodologji e detajuar monitorimi që përfshin shtatë lloje monitorimesh si më poshtë: [39]

1. Monitorimi i performancës, që vlerëson rezultatet dhe efektivitetin e programeve.
2. Monitorimi financiar, që kontrollon përdorimin dhe menaxhimin e fondeve.
3. Monitorimi analitik, që analizon të dhënat dhe trendet për të bërë përmirësime të vazhdueshme.
4. Monitorimi operativ, që shqyrton proceset e brendshme dhe funksionimin e përditshëm të programeve.
5. Monitorimi i përshtatshmërisë, që siguron që programet janë të përshtatura për nevojat e përfituesve.

[39] Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Planeve Lokale Sociale: Përmirësimi i Ofrimit të Shërbimeve Lokale të Mbrojtjes Sociale, UNDP dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, 2023.

6. Monitorimi i situatës, që vlerëson kontekstin dhe kushtet në të cilat zbatohen programet.
7. Monitorimi i opinioneve/përshtypjeve, që merr parasysh mendimet dhe përvojat e përfituesve për të përmirësuar shërbimet.

Kjo qasje e gjithanshme në monitorim ndihmon që programet e mbrojtjes sociale të jenë më të përgjegjshme dhe të përshtatura për nevojat e komunitetit, duke përmirësuar kështu cilësinë e jetës për qytetarët. Planet vendore duhet të sigurojnë të paktën monitorimin e performancës dhe monitorimin financiar, duke garantuar kështu që programet të jenë transparente dhe të efektshme në zbatimin e tyre.

## 2.4 Vlerësimi Paraprak i Nevojave

Ky seksion ndjek kategoritë e përcaktuara në VKM 150/2019 Neni 4, i cili përmban listën e të dhënave të vlerësimit të nevojave që bashkitë duhet të përdorin për hartimin e planeve sociale dhe aplikimin në Fondin Social Qendror. Këto kategori përfshijnë informacion mbi demografinë lokale, profilin dhe karakteristikat socio-ekonomike të grupeve në nevojë, gjendjen dhe shpërndarjen e shërbimeve të kujdesit social, instrumentet e financimit të tyre, kapacitetet e strukturave përgjegjëse, programin e buxhetit vendor për shërbimet e kujdesit shoqëror, si dhe listën e shërbimeve të munguara. Duke u bazuar në këto të dhëna, bashkitë janë të detyruara të zhvillojnë plane dhe projekte për përmirësimin e kushteve dhe shërbimeve për komunitetin, duke përdorur burimet e Fondit Social Qendror për të adresuar nevojat më të rëndësishme dhe prioritare për qytetarët e tyre.

### 2.4.1 Të dhënat demografike dhe ekonomike bazë

*Tabela 1: Popullsia sipas Njësive Administrative të Bashkisë Fier*

| Njësia Administrative | Qytetet dhe Frashtrat | 2024 (Rregjistri Civil) | 2025 (Rregjistri Civil) |
|---|---|---|---|
| Qyteti Fier | Njësitë Nr.1, Nr. 2, Nr, Nr.3 dhe Nr. 4 | | 97065 |
| Njësia Qendër | Çlirim, Mujalli, Grecalli, Daullas, Afrim i Ri, Vadhizë, Zhupan, Drizë, Drizë Myrteza, Fshati Rom | | 12922 |
| Njësia Libofshë | Rreth Libofshë, Vanaj, Daullas, Agimi, Metaj, Gozhdaras, Havaleas, Ndërnënas, Hasturkas, Adriatik | | 10190 |
| Njësia Topojë | Seman, Gjokalli, Sheq Marinas, Sheq, Fushë, Grykë, Seman i Ri, Kavaklli | | 7586 |
| Njësia Mbrostar | Verri, Vajkan, Petov, Kallmi i Madh, Kallmi i Vogël, | | 10899 |
| Njësia Dërmënas | Dërmënas, Pojan, Kryegjatë, Havaleas, Hoxharë, Radostinë, Sulaj, Hamil, Muçaj, Baltëz, Povelçë, Darëzezë e Re | | 13349 |
| Njësia Portëz | Portëz, Mbyet, Plyk, Kraps, Lalar, Patos Fshat. | | 11902 |
| Njësia Levan | Levan, Ferras, Peshtan i Madh, Peshtan i Vogël, Shtyllas, Bishan, Bashkim, Boçovë, Martinë, Pishë Poro, Qarr | | 18292 |
| Njësia Frakull | Frakull e Madhe, Frakull e Vogël, Adë, Peshtan Bregas, Kafaraj, Kashishtë, Sheq Musalala, Çerven | | 11067 |
| Njësia Cakran | Cakran i Ri, Floq, Buz Madh, Hambar, Varibop, Vjosë, Kreshpan, Gjorgos, Vreshtas, Gorishovë, Gjonç | | 16960 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **TOTALI** | | | 210232 |
| *Burimi: Bashkia Fier* | | | |

Fieri ndodhet në pjesën perëndimore të Shqipërisë, rreth 18 km larg bregut të Detit Adriatik. Bashkia e Fierit gëzon një pozicion gjeografik dhe strategjik të favorshëm, duke qenë e vendosur në kryqëzimin e dy korridoreve kryesore të vendit. Si një qendër e rëndësishme rrugore kombëtare, Fieri ofron avantazhe të mëdha për zhvillimin ekonomik.

Territori i Bashkisë Fier është një fushë e hapur gjeografike, e kufizuar nga bashkitë Divjakë, Lushnje, Roskovec, Patos, Mallakastër, Selenicë dhe Vlorë. Ai përfshin 5.7% të territorit bujqësor të vendit dhe është i pasur me dy lumenj kryesorë, Semanin dhe Vjosën. Gjithashtu, Fieri ka një pozicion strategjik për lidhjen me Gazsjellësin TAP, i cili kalon përmes territorit të saj.

Pas Reformës Administrative-Territoriale të vitit 2014, Bashkia e Fierit ka një sipërfaqe prej 620 km2 dhe një popullsi me një trend në rritje nga 209 265 në 2023 ne 210 232 ne vitin 2025 duke përfshirë 13 njësi administrative. Përafërsisht 46% e popullsisë jeton kryesisht në qytetin e Fierit, i cili është organizuar në 4 njësi administrative urbane. Pjesa tjetër e banorëve, rreth 54%, jeton në 9 njësi administrative rurale. Njësisë administrative Cakran dhe Levan janë dy prej njësive më të mëdha në Bashkinë Fier.

Në aspektin ekonomik, Bashkia e Fierit ka një ekonomi të përqendruar kryesisht në bujqësi dhe përpunimin e produkteve bujqësore, ndjekur nga sektori industrial dhe tregtia. Për shkak të burimeve natyrore dhe pozicionit pranë detit, si dhe ekzistencës së zonave arkeologjike të rëndësishme, Fieri ka potencial turistik të konsiderueshëm. Megjithatë, deri tani, turizmi nuk është ende një sektor kryesor në ekonominë e tij, siç tregojnë edhe numrat e ulët të ndërmarrjeve të hotelerisë.

Në aspektin e shërbimeve publike, Bashkia Fier përmbush nevojat për objekte arsimore dhe shëndetësore, megjithatë ka nevojë për investime në zgjerimin e shërbimeve ambulatore dhe për diversifikim të ekonomisë drejt sektorëve më të zhvilluar si industritë dhe tregtia. Plani për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, si dhe Planin për Strehimin Social 2023-2028, janë disa nga planet e përfshira në përpjekjet për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe shërbimet e kujdesit social për komunitetin.

## 2.4.2 Profili dhe karakteristikat e kategorive në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror

| | **Bashkia Fier** | **Fier** | **Nj.A Qëndër** | **Nj.A Levan** | **Nj.A Libofshë** | **Nj. A Topojë** | **Nj.A Dërmënas** | **Nj. A Frakull** | **Nj. A Cakran** | **Nj.A Mbrostar** | **Nj.A Portëz** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Përfitues të NE | Familje përfituese gjithsej ; viti 2025 | 109 | 24 | 52 | 29 | 25 | 27 | 20 | 76 | 28 | 24 |
| | Ndër të cilat : familje në fshat ( rurale) | 305 | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| | Masa mesatare e përfitimit në Lek (2025) | 3750 | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| | Ndër të cilat përfituese të NE përmes fondit të (6%) | 44 | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Karakteristika të familjeve përfituese të NE ; viti 2025 | **Familje me grua kryefamiljare** | 2 | 5 | 7 | 6 | 9 | 19 | 5 | 21 | 3 | 1 |
| | **Familje me deri 2 fëmijë të mitur** | 16 | 10 | 31 | 20 | 14 | 28 | 15 | 43 | 21 | 20 |
| | Familje me mbi 2 fëmijë të mitur | 1 | 5 | 13 | 3 | 2 | 8 | 1 | 2 | 5 | 3 |
| | Familje rome | - | 9 | 34 | - | 3 | 10 | - | - | 5 | - |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Familje me të paktën 1 anëtar PAK | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| | Familje me të paktën 1 anëtar në moshë pensioni | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Familjet përfituese sipas kategorive: viti 2025 | Familje në nevojë | 25 | 17 | 43 | 33 | 21 | 38 | 21 | 65 | 29 | 28 |
| | Jetimë | 29 | - | 3 | - | - | 1 | - | 1 | 4 | - |
| | Prindër shumënjakësh | 1 | | | | | | | | | |
| | Viktima trafikimi | 3 | | | | | | | | | |
| | Viktima dhune në familje | 32 | 5 | 2 | 4 | 10 | 10 | 10 | 20 | 7 | 5 |
| | Familje me fëmijë në kujdestari | 18 | - | - | 3 | - | 1 | - | 4 | 2 | - |
| | | | | | | | | | | | |

1. **Familje të varfra në skemën e Ndihmës Ekonomike**. Bazuar në treguesit e shpërndarjes së varfërisë (Harta e Varfërisë), Bashkia Fier përfshihet në grupin e parë (shkalla e varfërisë) me 0,1 – 10% të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike.[40]. Për vitin 2025, rreth 414 familje janë përfituese të NE, me një masë mesatare prej 3750 lekë/muaj. Përqëndrimi më i lartë në njësinë administrative Cakran (me mbi 17.03 %) dhe më i ulët në njësinë administrative Qender (me 4. %) tregon për dallimet në zhvillim dhe mundësi midis njësive administrative.
2. **Fëmijët në rrezik për shfrytëzim dhe trafikim**. Fëmijët në rrezik të shfrytëzimit dhe trafikimit përfshijnë ata që jetojnë në familje të varfra ose zona me kriminalitet të lartë, fëmijët e braktisur ose të privuar nga familja, ata që vuajnë nga abuzimi në familje, fëmijët me prindër të divorcuar dhe situata të vështira sociale dhe ekonomike, ata që braktisin shkollën, si dhe fëmijët e komuniteteve që përballen me diskriminim racial, përfshirë romët dhe egjiptianët, veçanërisht ata që janë kthyer nga proceset e azilit ose emigracioni i pasuksesshëm. Këta fëmijë zakonisht janë subjekt i braktisjes së shkollës dhe punësimit të hershëm informal dhe janë të rrezikuar nga trafikimi dhe shfrytëzimi për qëllime seksuale, prostitucioni, puna e detyruar, lypja në rrugë, apo trafikimi i organeve.

*Tabela 3: Nr. i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje të trajtuar me Plan Individual Mbrojtjeje (PIM) nga Bashkia Fier*

| Vitet | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|---|
| Nr. i fëmijëve të trajtuar me PIM në 13 Njësitë Administrative | 28 | 30 | 29 | 32 | 35 |

*Burimi: NJMF, Bashkia Fier*

Sipas raportit të Shërbimit Social Shtetëror, në Bashkinë Fier 500 fëmijë trajtohen me shërbime sociale të ndryshme, nga të cilët 75 fëmijë me aftësi ndryshe marrin shërbime pranë Qendrës "Horizont" [41]. Ndonëse numri i rasteve të trajtuara çdo vit me plan individual mbrojtjeje nga Bashkia Fier raportohet në rreth 30 - 40 raste, vlerësohet se numri i fëmijëve në nevojë për mbrojtje në 13 njësitë administrative të Bashkisë Fier mund të jetë shumë më i madh. Ndër arsyet e mos identifikimit dhe referimit të rasteve është edhe mungesa strukturave të NJVNR-së nivel Bashkie dhe Njësie Administrative.

[40] Bashkia Fier 2023.
[41] Raport mbi ecurinë e Planeve Sociale në Bashkitë e Qarkut Fier, Shërbimi Social Shterëror, 02.02.2023.
[56] Plani Lokal i Zhvillimit, Pjesëmarrjes e Gjithëpërfshirjes për PAK në Rajonin e Fierit.

3. **Personat me aftësi të kufizuar dhe Invalidë**. Personat me aftësi të kufizuara që përfitojna pagesë nga skema e PAK ndahen në shtatë kategori, ku përfshihen (1) invalid me pension pleqërie; (2) invalid pune të pjesshëm; (3) invalid pune të plotë; (4) paraplegjike dhe teraplegjikë; (5) kujdestarë për para-tetraplegjikë; (6) të verbër; dhe (7) kujdestar për të verbër. Disa grupe, siç janë gratë me aftësi të kufizuara, apo romët me aftësi të kufizuar, vuajnë diskriminim e shumëfishtë për shkak të përkatësisë gjinore apo racore.

   Sipas të dhënave të "Planit Lokal të Zhvillimit, Pjesëmarrjes e Gjithëpërfshirjes për PAK" në Rajonin e Fierit, numri i personave me aftësi të kufizuar në Bashkinë Fier është 3.4% e numrit të përgjithshëm të popullsisë. Nga këta 6.6% janë invalidë në pension pleqërie, 11% janë invalidë të pjesshëm pune, 37% janë invalidë pune të plotë, 5.6% janë para dhe tetraplegjikë, 9.7% janë të verbër dhe 30% janë me aftësi të kufizuar. Brenda numrit të mësipërm, 62.4% e personave me aftësi të kufizuar në qytetin e Fierit janë në moshë pune. Prej tyre, 72%, ose 1,260, janë invalidë pune dhe 28%, ose 484, janë persona me aftësi të kufizuar fizike dhe mendore.[56]

   Sipas të dhënave të fundit (2025), në Bashkinë e Fierit, numri i individëve me aftësi të kufizuara është rreth 4528 banorë, ose thënë ndryshe, 2% e popullsisë. Në aspektin e strukturës administrative, numri më i lartë i individëve me aftësi të kufizuara gjendet në Njësinë Administrative Cakran, njësitë ku popullsia është më e dendur, ndërsa për invalidët e punës,numri më i lartë është në Njësinë Administrative Levan.

*Tabela 4: PAK, sipas NJA-ve 2025*

| **Njësia Administrative** | **PAK** | kujdestari |
|---|---|---|
| Fier ( qyteti me 4 Rajonet ) | 1886 | 421 |
| Nj.A Qendër | 233 | 33 |
| Nj.A Levan | 354 | 51 |
| Nj.A Mbrostar | 271 | 42 |
| Nj.A Portëz | 268 | 46 |
| Nj.A Dërmënas | 313 | 97 |
| Nj.A Topojë | 213 | 39 |
| Nj.A Frakull | 233 | 42 |
| Nj.A Libofshë | 264 | 53 |
| Nj.A Cakran | 511 | 66 |
| **Total** | 4528 | 890 |

*Burimi i të dhënave: Bashkia Fier*

*Nr. Familjeve të Pastrehë dhe atyre aplikues/përfitues të Programeve të Strehimit Sociale 2019-2023*

| **Vitet** | | **2021** | **2022** | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Programi i Strehimit Social** | | - | - | - | - | - |
| **Banesë sociale** me qira | Aplikues | - | 6 | 18 | 24 | 27 |
| | Përfitues | 5 | - | - | 1 | 3 |
| **Bonus strehimi** (subvencion qiraje ne tregun e lire) | Aplikues | - | 25 | 18 | 15 | 19 |
| | Përfitues | - | 19 | 16 | 14 | 12 |
| **Banese me kosto të ulët/** Subvencioni i interesave të kredisë/Kredi me kushte te lehtësuara | Aplikues | - | 30 | - | - | - |
| | Përfitues | - | 19 | 16 | 15 | 29 |
| **Rikonstruksion** banese ekzistuese | | - | - | - | - | - |
| **Totali i familjeve përfituesëve nga të gjitha programet** | | | **38** | **32** | 30 | 44 |
| **Familje të rregistruara si të pastrehë** | | | | | | |

| Raporti të pastrehë/përfitues | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *Burimi: Drejtoria e Strehimit Social, Bashkia Fier* | | | | | | |

**4.Familje të pastreha**. Numri i familjeve të pastreha në Bashkinë e Fierit është në rritje, duke kërkuar strehim dhe investime të reja në këtë fushë. Deri në vitin 2025, një numër i caktuar i familjeve ka marrë banesa sociale në këtë bashki, por kërkesat për strehim janë shumë më të mëdha se numri i banesave të disponueshme. Bashkia e Fierit vlerësohet të ketë mbi 1,500 familje të pastreha. Familjet e pastreha që kanë marrë strehim janë miratuar në përputhje me ligjin nga Këshilli i Bashkisë dhe kanë lidhur kontrata me Drejtorinë Rajonale të Entit të Banesave Fier, bazuar në tipin dhe vlerën e apartamenteve të marrë. Nevoja për strehim social vazhdon të jetë shumë e lartë. Raporti mes numrit të aplikimeve dhe atyre që përfitojnë është 1 për 5.

Ligji për strehimin social dhe nënligjore përcaktojnë 6 programe strehimi për bashkitë, duke përfshirë banesat sociale me qira, përmirësimin e banesave ekzistuese, banesat me kosto të ulët, zhvillimin e zonave për strehim, krijimin e banesave të përkohshme, dhe banesat e specializuara. Bashkia Fier aktualisht zbaton programet e banesave me kosto të ulët dhe banesat sociale me qira, duke përfshirë subvencionimin e kredisë dhe qirasë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dhënë fonde për strehim për një numër të caktuar familjesh.

*Tabela 5: Fondet e alokuara nga Qeveria Qendrore për Bashkinë Fier për programet e strehimit*

| Viti | Numri i familjeve përfituese | Bonus strehimi /vlera |
|---|---|---|
| 2022 | 25 | 1,383,960 |
| 2023 | 16 | 988,918 |
| 2024 | 30 | |
| 2025 | 44 | |
| **Totali** | 115 | |

*Burimi: Plani Vendor i Strehimit Social 2023-2028 sipas të dhënave nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Fier*

Siç sqarohet në Planin Vendor të Strehimit Social 2023-2028 të Bashkisë Fier[42], në mungesë të banesave sociale me qira të lira për t'u shpërndarë për familjet në nevojë, familjet e pastreha janë orientuar për t'u trajtuar me nën programin e subvencionit të qirasë në tregun e lirë. Pjesa me e madhe e familjeve që kanë aplikuar për subvencion qiraje në tregun e lire, janë miratuar me vendim te Këshillit të Bashkisë, dhe eshte vijuar me likujdimin e pagesave sipas kritereve dhe tabeles orientuese te percaktuar paraprakisht.

Programi i Banesave me Kosto të Ulët, u aplikua fillimisht në vitin 2016-2017 dhe u ndërtuan 75 apartamente për të strehuar familjet në nevojë në qytetin e Fierit. Për herë të parë, një perqindje e konsiderueshme e shtëpive sociale (banesave me kosto të ulët) janë në përputhje me parimet e efiçiencës së energjisë, duke u mundësuar familjeve të ulin faturat e energjisë elektrike.

Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese ofron ndihmë për ndërtimin e ri të banesave në bazë të nevojave për strehim. Për vitin 2022 sipas të dhënave nga Bashkia Fier kanë përfituar 49 familje rome për rikonstruksion banesash. Ky program ka një shtrirje afatgjatë dhe synon të përmirësojë kushtet e banesave ekzistuese.

Planit Vendor të Strehimit Social, Bashkia planifikon të propozojë projekte bashkëfinancimi për të ndërtuar më shumë banesa me kosto të ulët, duke bashkëpunuar me Entin Kombëtar të Banesave.

[42] Plani Vendor i Strehimit Social 2023-2028, Bashkia Fier.

Gjithashtu, ka një program për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese dhe për të trajtuar rastet e emergjencave natyrore apo lëvizjeve migratore të popullsisë.

5. **Viktima të dhunës në familje.** Numri i rasteve të viktimave të dhunës në familje në vitet e fundit ka qenë në rritje. Aktualisht, janë 110 raste dhune në familje që marrin shërbime shëndetësore, shërbime ligjore falas, shërbime psikologjike, ndihmë ekonomike, referime pranë organizatave dhe ndihma me paketa ushqimore, veshëmbathje dhe artikuj shkollorë.[43] Drejtoria e Shërbimit Social pranë Bashkisë Fier u ka dhënë përparësi familjeve në nevojë dhe kryesisht familjeve me gra krye-familjare. Ndonëse ka mungesë të buxheteve të përcaktuara për barazinë gjinore në nivel vendor, nevojitet një ndërgjegjësim më i lartë dhe ndihmë parandaluese për viktimat e mundshme. Aktualisht rezulton që ka një numër relativisht të lartë të numrit të Urdhrave të Mbrojtjes dhe kjo kërkon një koordinim dhe specializim të të gjithë stafit në të gjitha institucionet e përfshira për trajtimin e problematikës që lidhet me dhunën në familje, ndërsa mungojnë programet e rehabilitimit lokal. Ky shërbim i munguar është realizuar në bashkëpunim me qendrën 'Vatra" ne Vlorë dhe Qendrën Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare. Viktimat e dhunës krahas nevojave për trajtim me bonus qiraje kanë nevoje edhe për mbështjetje në fushën e punësimit.

6. **Të moshuarit e vetmuar**. Shtëpia e të moshuarve prej 2007 në varësi të Bashkisë së Fier ka një kapacitet për 55 të moshuar. Sipas raportimeve, Shtëpia e të moshuarve ka nevojë si për një përmirësim të strukturës se ndërtesës, për staf të kualifikuar si dhe për pajisjen e saj me mjetet e nevojshme, siç janë karriget me rrota, krevate të përshtatshëm për persona me aftësi të kufizuar, karriget dhe mbajtëset e dushit etj. Shtëpia ofron shërbim 24 orë dhe ka nevojë për kujdes shëndetësor dhe jo vetëm rezidencial.

*Table 6: Nr i të moshuarve të vetmuar*

| | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|
| Rezident në Qendrën e të Moshuarve, Fier | 52 | 55 | 55 |
| Jo resident (*të paktën*) | *100* | *100* | *100* |

*Burimi: Bashkia Fier*

*Tabela 7: nr. i fëmijëve rom dhe egjiptian në të gjitha nivelet arsimore parauniversitare në Bashkinë Fier*

| **Kategoritë e fëmijëve sipas programit arsimore** | **Rom/Egjiptian** | **2023** | **2024** | **2025** |
|---|---|---|---|---|
| Nr. i fëmijëve rom/egjiptian që rekuentojnë 69 kopështet publike | Romë | 102, nga të cilët 52 femra | 75, nga të cilët 35 femra | 78, nga të cilët 35 femra |
| | Egjiptianë | 3, nga të cilët 1 femër | - | - |
| Nr. i nxënësve rom/egjiptian në arsimin e detyruar 9 vjeçar | Romë | - | - | *310*[44] |
| | Egjiptianë | - | | - |

[43] Shih, Raportin mbi ecurinë e Planeve Sociale në Bashkitë e Qarkut Fier, Shërbimi Social Shterëror, 02.02.2023.

[44] Sipas z. Fatos Koçi, Drejtor Ekzekutiv i organizatës rome 'Voice of Roma in Albania' (VRA) e cila vepron në Fier, shpërndarja e këtyre 310 nxënesve romë është si më poshtë: 59 nxënës në Baltëz; 10 nxëneës në Sektor Seman; 29 nxënës në Mbrostar; 79 nxënës në Fshatin Rom/Drizë; 118 nxënës në Levan; dhe 15 nxënës në Fermë Çlirim.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. i nxënësve rom/egjiptian në arsimin e mesëm të përgjithshëm | Romë | - | - | *4*[45] |
| | Egjiptianë | - | - | |
| Nr. i nxënësve rom/egjiptian në arsimin e mesëm profesional | Romë | - | - | *14* |
| | Egjiptianë | - | - | - |
| *Nr. i fëmijëve rom/egjiptian në situatë rruge apo jashtë sistemit arsimor* | *Romë* | - | - | |
| | *Egjiptianë* | | | *30*[46] |
| Burimi: Zyra Vendore Arsimore, Fier dhe *Organizata 'Voice of Roma in Albania' (VRA)* | | | | |

Prej 2018, Bashkia ka marrë me qera ambiente në fshatin Topojë, për ndërtimin e një qendre ditore për të moshuarit. Gjithashtu, për këtë grup shoqëror, Bashkia ofron edhe një Qendër Ditore të hapur, ku ofrohen shërbime rekreacioni dhe kujdesi.

7. **Komunitetet rome dhe egjiptiane. Komunitetet Rome dhe Egjiptiane në Fier**. Sipas të dhënave të vitit 2015, popullsia Rome në Fier llogaritet të jetë 4,231 banorë, të cilët përfaqësojnë 1,011 familje. Numri më i madh i tyre gjendet në njësinë administrative Qendër Fier, me 352 familje, pasuar nga Dërmënasi me 285 familje dhe Levani me 270 familje. Në përgjithësi, familjet rome dhe egjiptiane përballen me sfida të mëdha për të përballuar kostot e shërbimeve për një jetë të dinjitetshme, përfshirë ujin e pijshëm dhe energjinë elektrike. Përveç kësaj, problemet me pronën dhe punësimin e parregullt bëjnë që shumica e këtyre familjeve të mbeten në rrjetin e varfërisë dhe të përballen me qëndrime përçmuese dhe diskriminuese, duke hasur vështirësi në integrimin social dhe ekonomik në shoqëri.

Në fushën e arsimit, fëmijët rom dhe egjiptian hasin me një sërë problematikash si mungesa e frekuentimit të rregullt, braktisja e shkollës dhe performanca e ulët. Shkaqet kryesore përmenden të jenë pamundësia ekonomike dhe nevoja për të filluar punën informale shumë herët, migracioni i parregullt (brenda dhe jashtë vendit), inferioriteti social-ekonomik shoqëruar me përbuzjen raciale dhe qëndrimet diskriminuese në ambientet shkollore. Këto shkaqe jo vetëm pengojnë arritjen e rezultateve të mira në mësim, por largojnë çdo shpresë për një arsimim të rregullt. Në këtë situatë të pashpresë, vajzat romë, në veçanti, ndërpritin shkollimin e tyre në moshë të re për të martuar herët.

Edhe pse mungojnë të dhëna për fëmijët
jashtë sistemit, vlerësohet se rreth 10% e fëmijëve rom dhe egjiptianë në moshën e arsimit të detyrueshëm momentalisht janë jashtë sistemit arsimor. Për më tepër, pengesë për frekuentimin e shkollës është edhe infrastruktura dhe aksesimi i ulët që këto komunitete kanë në institucionet arsimore. Mungesa e transportit, tualetet dhe uji i rrjedhshëm në shkollat që frekuentohen nga komunitetet romë/egjiptianë janë gjithashtu problematike.

Sipas Planit Vendor mbi Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2019-2023, rreth 21% e familjeve rome përfitojnë ndihmë ekonomike si familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme. Një pjesë e konsiderueshme e familjeve rome dhe egjiptiane e sigurojnë jetesën nëpërmjet aktiviteteve prodhuese kryesisht informale në fushat e bujqësisë, blegtorisë, tregtisë ambulante, ndërtimt, dhe në sektorin e shërbimeve si pastrimi apo industria e muzikës. Megjithatë, punësimi formal dhe siguria ekonomike e këtyre familjeve është mjaft e ulët. Qëndrimet paragjykuese dhe praktikat diskriminuese të ngulitura thellë në ndërgjegjen e

[45] Sipas organizatës rome VRA, gjithësej 18 nxënës romë ndjekin arsimin e mesëm të përgjithshme dhe atë profesonal.
[46] Nuk ka të dhëna të sakta mbi këta kategori. Gjatë diskutimeve me përfaqësues të komuniteteve rome ky numër vlerësohet rreth 30 fëmijë, familjet e të cilave migrojnë sezonalisht brenda dhe jashtë vendit.

popullsisë së shumicës dhe të reflektuara në praktikat institucionale, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, vazhdojnë të përjashtojnë anëtarët e komuniteteve rome dhe egjiptiane nga sigurimi i mjaftueshëm i të ardhurave nga sektori informal dhe nga integrimi në tregun formal të punës. [47]

Sipas të dhënave të Zyrës së Punës Fier, një numër shumë i vogël individësh nga komunitetet rome kanë përfituar nga programet e formimit profesional dhe ato të nxitjes së punësimit. Gjatë periudhës 2023 2025, vetëm 102 individë (70 meshkuj dhe 32 femra) romë kanë përfunduar kurse profesionale, nga të cilët vetëm 5 individë janë punësuar. Ndërkohë, numri i punëkërkuesve të regjistruar është rritur në 210 në vitin 2025. Këto të dhëna tregojnë nevojën për një analizë të thelluar mbi sfidat dhe mundësitë e integrimit të komuniteteve rome dhe egjiptiane në tregun e punës.

*Tabela 8: Të dhëna mbi përfshirjen e romëve në programet e aftësimit dhe punësimit në Fier*

| Vitet | **2023** | **2024** | **2025** |
|---|---|---|---|
| Nr. i grave rome që përfunduan kurse formimi | 19 | 25 | 29 |
| Nr. i burrave rom që përfunduan kurse formimi | 7 | 34 | 20 |
| Nr. i grave rome të punësuara në programet e nxitjes | - | - | - |
| Nr. i burrave rom të punësuara në programet e nxitjes | 2 | - | 14 |
| Nr. i individëve rom që janë mbështetur me mikro-grante për hapjes e një biznesi të ri | - | - | - |
| Nr. i individëve rom që janë mbështetur me mikro-grante për fuqizimin e një biznesi ekzistues | - | - | - |
| Nr. i punëkërkuesëve rom që nuk kanë gjetur punë | 169 | 133 | 210 |

*Burimi: AKPA, Zyra e Punës Fier*

Problematikat e strehimit variojnë nga mungesa e plotë e strehimit deri te kushtet e papërshtatshme të banesave, duke përfshirë banesat e ndërtuara pa kushtet minimale të sigurisë dhe pa dokumentacionin e nevojshëm. Në Bashkinë Fier, që nga viti 2018, janë zbatuar programe strehimi nga të cilat kanë përfituar edhe familje rome dhe egjiptiane. Megjithatë, shumica e familjeve rome nuk mund të përfitojnë nga këto programe ose për shkak të mungesës së dokumentacionit të rregullt, ose sepse jetojnë në banesa me strukturë të paqëndrueshme apo në vende të pasigurta pranë hekurudhës.Problematikat e strehimit shoqërohen me situata ku familjet e mëdha ndajnë strehën me familjen e gjerë, duke krijuar mbipopullim dhe vështirësi në përballimin e kostove të shërbimeve, si uji i pijshëm dhe energjia elektrike, duke përfshirë kostot për lidhjen e kontratave dhe përballimin e tarifave të shërbimeve. Për më tepër, familjet rome dhe egjiptiane e kanë thuajse të pamundur të përfitojnë nga programet e strehimit që ofrojnë kredi të buta, pasi punësimi i tyre është kryesisht i parregullt dhe joformal, duke bërë të pamundur vërtetimin e të ardhurave. Gjithashtu, shumica e rrugëve të brendshme nuk janë të shtruara ose të ndriçuara dhe ka nevojë për ndërhyrje në kanalizime për të përmirësuar kushtet e jetesës.[48]

Në fushën e kujdesit shëndetësor, raportohet se qendrat shëndetësore pranë vendbanimeve me përqendrim të pakicave rome dhe egjiptiane nuk janë të mirë-pajisura. Mungojnë pajisjet mjekësore, sistemi i ngrohjes dhe ftohjes, dhe uji i ngrohtë. Edhe pse përgjithësisht janë të regjistruar me një mjek familjeje, aksesi në shërbimet e kujdesit shëndetësor është relativisht i ulët për shkak të mungesës së kartave të shëndetit dhe kontributeve në skemën e sigurimeve shëndetësore, gjë që lidhet me nivelet e ulëta të punësimit formal. Fëmijët dhe gratë shtatzëna janë kategoritë më të rrezikuara. Fëmijët e parregjistruar janë automatikisht të përjashtuar nga

[47] *Shih* Planin Vendor mbi Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2019-2023.
[48] Shih Planin Vendor mbi Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2019-2023.

marrja e shërbimit shëndetësor, veçanërisht sigurimi i vaksinimit të tyre. Është e nevojshme që fëmijët të pajisen me kartela vaksinimi dhe karta shëndeti, pavarësisht gjendjes së tyre civile dhe ekonomike.

Jo të gjitha gratë shtatzëna kanë mundësi të aksesojnë shërbimet shëndetësore dhe kanë nevojë për informim dhe ndërgjegjësim për mëmësinë dhe shëndetin e nënës dhe fëmijës. Siç raportohet, rreth 350 familje ose 30% e familjeve rome dhe egjiptiane janë larguar kryesisht si azil-kërkues në Gjermani dhe Francë. Gjatë viteve të fundit, një pjesë e mirë e tyre janë kthyer. Një analizë e plotë e situatës është e nevojshme në këtë fushë dhe për këtë qëllim, Bashkia Fier ka ngritur një grup pune për migracionin dhe diasporën. Ky grup po ndjek një paketë trajnimesh të ofruara nga organizata GIZ, pas përfundimit të së cilave planifikohet hartimi i një plani të veçantë për të rikthyerit, emigrantët dhe diasporën. Në këtë drejtim, është e domosdoshme që plani i dedikuar për të rikthyerit të marrë në konsideratë problematikat specifike me të cilat përballen familjet rome dhe egjiptiane.

Problemet më shqetësuese lidhen me fëmijët e rikthyer dhe përfshijnë çështje si: regjistrimi i fëmijëve të lindur jashtë vendit; njohja e gjendjes shëndetësore dhe vaksinimi i tyre; si dhe riintegrimi në sistemin arsimor. Për shumicën e familjeve rome dhe egjiptiane, këto procese janë të vështira për t'u ndjekur dhe shpesh i detyrojnë të kthehen në ri-emigrimin e parregullt ose azilin. Po ashtu, emigrimi sezonal, kryesisht gjatë verës, në Itali dhe Greqi është një fenomen që, nëse orientohet larg lypjes dhe drejt marrjes së aftësive, mund të përbëjë një potencial të dobishëm social-ekonomik.

Koncepti i rregjistrimit civil nuk duhet të shihet si i kufizuar tek regjistrimi fillestar i fëmijëve në regjistrin e gjendjes civile, por duhet të përfshijë të gjitha problematikat që lidhen me rregjistrimin në shkolla, pajisjen e fëmijëve me kartela vaksinimi dhe karta shëndeti, pajisjen e individëve mbi 16 vjeç me karta identiteti dhe karta shëndeti, sigurimi i një adrese apo transferim vendbanimit, etj.). Gjithashtu, digjitalizimi thuajse i gjithë shërbimeve sjell nevojën që shërbimi i ndihmës ligjore falas të plotësohet duke përfshire edhe asistencën për të aksesuar platformën e-Albania krahas ofrimit të ndihmës ligjore parësore (përfshirë edhe rregjistrimin civil) dhe atë dytësore në proceset gjyqësore administrative, civile, dhe penale.

*Tabela 9: Nr. i personave rom/egjiptian përfitues të ndihmës ligjore falas*

| Vitet | | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| Ndihma ligjore parësore | Këshillim ligjor | 8 | 15 | 24 |
| | Përgatitje dokumentacioni (përfshirë rregjistrim civil) | | | |
| | Akses në platformën e-Albania | | | |
| Ndihma ligjore dytësore | Çështje gjyqësore administrative | 1 | 10 | 15 |
| | Çështje gjyqësore civile | | | |
| | Çështje gjyqësore penale | | | |
| Totali | | 9 | 25 | 39 |

*Burimi: Zyra Vendore e Ndihmës Ligjore, Fier*

Megjithëse janë bërë përpjekje nga qeveria qëndrore dhe ajo vendore për përmirësimin e situates së komuniteteve rome dhe egjiptiane në fushat e arsimit, punësimit, strehimit, shërbimit shëndetësor, dhe regjistrimit civil situate, këto komunitete ende mbeten larg një përmirësimi domedhënës dhe vijojnë të jënë viktimë e përjashtimit social dhe diskriminimit. Për më tepër, raportet e monitorimit të zbatimin e planit vendor mbi romët dhe egjiptianët thekson se duhet të intensifikohen përpjekjet në sektorin publik dhe atë privat, të sigurohen mbledhja dhe përpunimi i të dhënave mbi treguesit e performancës, të rritet kapacitetet e strukturave të

bashkisë lidhur me hartimin dhe zbatimin e masave që targetojnë komunitetet rome dhe egjiptiane, të përmirësohet angazhimi dhe përfshirja e të gjitha strukturave bashkëpërgjegjëse brenda bashkisë, si dhe forcohet bashkëpunimi, koordinimi dhe bashkërendimi i punës midis strukturave të bashkisë dhe strukturave sektoriale në varësi të institucionave qendrore.[49] Gjithashtu, Bashkia Fier duhet t'i kushtojë vëmendjë të shtuar koordinimit afatgjatë gjatë të gjitha fazave të planifikimit, zbatimit, monitorim-vlerësimit me organizatat donatore, organizatat e specializuara si dhe organizatat dhe shoqatat komunitare.

8. **Të rinjtë në nevojë për shërbime integruese, rehabilituese dhe parandaluese.** Në këtë kategori përfshihen jetimët, personat në shërbim prove, ish të dënuarit, përdoruesit e drogës/alkoolit, apo ata që kanë sjellje agresive.
   Lidhur me të rinjtë në konflikt me ligjin, Bashkia Fier vazhdon bashkëpunimin me Zyrën e Shërbimit të Provës dhe strukturat e policisë së shtetit dhe Prokurorin e Fierit për ri-integrimin e tyre në shoqëri. Sipas të dhënave të siguruara për vitin 2025, vlerësohet se janë të paktën 170 të rinj në rrezik të cilët kanë nevojë për shërbime sociale të ndryshme.

*Tabela 10: Të rinj në rrezik dhe në nevojë për shërbime integruese, rehabilituese, dhe parandaluese*

| **Kategoritë** | | **2023** | **2024** | **2025** |
|---|---|---|---|---|
| 1.Jetim | | 1 | 4 | |
| 2.Në shërbimi prove | | 9 | 69 | 70 |
| 3.Ish të dënuar | | 1 | 4 | 10 |
| 4.Përdorues të trajtuar apo identifikuar për varësi: | nga droga | 16 | 20 | 15 |
| | nga alkooli | 6 | 15 | 15 |
| 5.Të rinj që shfaqin sjellje agresive[50] | | - | 20 | 60 |
| **Total** | | **33** | 132 | 170 |

*Burimi: 1. Bashkia Fier,2. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës, 3. Policia/Prokuroria, 4. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, 5. Strukturat përgjegjëse për policimin në komunitet.*

Në vitin 2019, pranë ambienteve të Qendrës Multifunksionale Fier, në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Bashkisë Fier dhe Ministrisë së Drejtësisë për sigurimin e strukturave infrastrukturore dhe institucionale për zbatimin e masave alternative për të miturit në konflikt me ligjin, është vënë në dispozicion një ambient zyre. Këtu, të rinjtë jo vetëm që kryejnë punë komuniteti, por marrin edhe shërbime psikologjike nga një psikolog i angazhuar nga Bashkia për këtë qëllim.

Të rinjtë përdorues të alkoolit ose drogës, si dhe ata që vuajnë nga varësia, janë gjithashtu në nevojë për shërbime të cilat ofrohen pranë Spitalit Rajonal Fier. Kategoria e veçantë përfshin të rinjtë me sjellje agresive ose probleme shëndetësore mendore të cilët janë vlerësuar nga mjeku si rrezik për sigurinë publike. Për të adresuar këto probleme, është e nevojshme një koordinim ndërinstitucional midis strukturave përgjegjëse në Bashki dhe atyre në institucionet arsimore, shëndetësore, policore dhe shërbimin e provës.

### 2.4.3 Shërbimet ekzistuese dhe shpërndarja e tyre në territorin e Bashkisë Fier

Bashkia Fier ka një numër relativisht të lartë institucionesh sociale (19), që është më i madh se në Elbasan dhe Vlorë, por më i vogël se në Durrës dhe Shkodër. Në nivel qarku, operojnë 2 qendra për të moshuar (1 rezidenciale publike dhe 1 ditore private), 9 qendra sociale për fëmijë (jo publike), 3 shërbime sociale private ditore për familjet dhe komunitetet, 3 shërbime sociale ditore për personat me aftësi të kufizuara, dhe një qendër sociale për të rinjtë.

---

[49] Raport Monitorimi mbi zbatimin e Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane (2019-2022), Bashkia Fier.

[50] Përfshirë por pa u kufizuar tek individët që janë identifikuar nga mjeku me çrregullime të shëndetit mendor që përbëjnë kërcënim për sigurinë publike.

Harta e shërbimeve sociale në territorin e bashkisë Fier[51] tregon se shumica e këtyre shërbimeve janë të fokusuar në zonën urbane të bashkisë, ndërsa mbulimi gjeografik i tyre në zonën rurale është i pamjaftueshëm. Pavarësisht tipologjisë së shërbimeve (si shërbime sociale për fëmijë, të moshuar, personat me aftësi të kufizuara, gra të dhunuara/viktima të trafikimit), në Fier identifikohen shërbime sociale rezidenciale dhe ditore. Shërbimet rezidenciale ofrohen nga Qendra rezidenciale për të moshuarit, ndërsa shërbimet ditore ofrohen për fëmijë, të moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara.

| | **Harta e Shërbimeve** | **Përfituesit** | **Ofruesi** | **Burimi Kryesor** | **Bashkia** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Pagesa Cash/NE dhe 6% nga Bashkia; familjen ne skemen ekonomike te perzgjedhur permes 54 indikatore. Treguesit jane te ngurte dhe bazim. Per ata qe nuk kualifikohen aplikohet 6% të totalit te NE I cili eshte njellog nga 2187 familje me 1 personi – 12,800 familje | Familje në nevojë dhe pa burime të ardhurash | Shërbimi Social Shtetëror https://www.sherbimisocial.gov.al/ndihma-ekonomike/ dhe Bashkia Fier | Fondi i kushtëzuar për NE nga MSHMS | Bashkia realizon përzgjedhjen e përfituesëve, shperndarjen e pagesave dhe mbajtjen e statistikave |
| 2 | Strehim dhe mbështjetje për 55 të moshuar | Të moshuar të vetmuar | Shtëpia e të Moshuarve në varësi të Bashkisë Fier | Fondi për shtëpinë e të moshuarve nga MSHMS | Bashkia ka mirembajtjen dhe investtime ne godine |
| 3 | Mbështetje arsimore për fëmijë me aftësi të kufizuar | Arsim i detyrueshem dhe terapi ditore me orare te caktuara për 33 fëmijë dhe 70 të tjerë të cilët ndikin terapitë ditore. Fëmijët me aftësi ndryshe 6-19 vjeç ndjekin arsimin ndërsa fëmijët me aftësi ndryshe 19-21 vjeç shërbejnë si vullnetar | Qendra Horizont në varësi të Bashkisë Fier | 6 mësues paguhen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Punonjës social Logoped Psikolog dhe 4 fizioterapist paguhen nga Bashkia; - Transport, ushqim mbulohen nga granti I MSHMS. | Pagat e stafit tjetër, perveç mesuesëve;<br><br>Energji dhe uji dhe mirëmbajtja e godinës mbulohen nga Bashkia |
| 4 | Ndihmë ligjore parësore/përfshirë proceset administrative dhe aksesimin e shërbimeve në eAlbania; Ndihmë ligjore dytësore për ndjekjen e proceseve | kategoritë e disavantazhuara | Shërbimi Ligjor Falas në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, atashuar pranë Bashkia Fier | Ministria e Drejtesise; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi | Referime rastesh të personave në nevojë/me urdhër mbrojtje/kujdestari te miturish;<br><br>Ofron ambjentet pranë Këshillit të Qarkut për |

[51] Bashkia-Fier.pdf (sherbimisocial.gov.al)

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | gjyqësore/Koordinartori rajonal I komisionerit per mbrojtjen ne fier | | | | Ndihmen Ligjore Falas/Zyrën Vendore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi |
| | Qendra komunitare pranë Banesave Sociale | Programe për Fëmijë dhe Familje të banesave socilae disavantazhuara (përfshirë komunitetet rome/egjiptiane):<br>1. Programe prindërim i;<br>2. Programe after school<br>3. Programe life skills<br>Këshillim psikologjik (mungon) | Qendra komunitare/Terres des Hommes | MSHMS mbulon të plotë pagat dhe shpenzimet operative për vitin e parë; Viti i dytë vijon me bashkë-financim; Viti u tretë mbulohet tërësisht nga Bashkia | Bashkia/TdH aplikuan për 36 muaj.<br>Bashkia duhet planifikojë fonde për vijimësinë e projekteve në këtë qendër |
| 6 | Shërbime emergjente për viktimat e mitur me forma të renda të dhunës seksuale | Të miturit/gratë viktima të krimeve seksuale | Qendra e Emergjences, Spitali Rajonal Fier | UNICEF deri ne fund të 2024, me pas MSHMS duhet të planifikoje | Rerefime rastesh dhe marrje të dhënash |
| 7 | Shërbime punësimi dhe formimi profesional | Për të gjithë personat mbi 16 vjeç | AKPA: https://www.puna.gov.al/<br>Zyra e Punës dhe Formimi Profesional Fier | Ministria Ekonomise dhe Shërbimi Kombetar I Punësimit | Bashkia ka marrëveshje me AKPA për nxitjen e punësimit për kategoritë në nevojë kryesisht në ndërmarjen e pastrim gjelberimit |
| 8 | Këshillim Psikologjik | Nxënësit e shkollës 9-vjecare dhe të mesme | ZVA | MAS | Referime rastesh dhe marrje të dhënash |
| | | Në kopështet publike ka 2 punonjës social dhe 2 psikologë | Qendra Ekonomike Arsimore, Bashkia Fier | Bashkia Fier | Pagat e stafit psiko-social në kopështe |
| 9 | Strehim emergjent dhe këshillim psikologjik | Individët në situatë emergjente dhune/trafikimi/rrezik trafikimi/fëmijë pa kujdes përindëror apo situatë shfrytëzimi | Qendra 72 orëshe e emergjencës nuk ekziston në Fier dhe rastet referohen në Vlorë dhe Tiranë, përkatësisht Qendra Vatra për grate e dhunuara dhe Qendra ARSIS për të miturit. | MSHMS, donatorë | Bashkia në konsultim me MSHMS duhet të vlerësojë mundësinë për ngritjen e qendrës 72 orëshe në Fier |
| 11 | Mbështetje për pjesëmarrjen e të rinjve dhe organizimi i kampe verore | Të rinjtë e të gjitha grupeve sociale | Qendra Epoka | Projekte donatoresh | Bashkia ofron ambjentet pranë qendrës ekonomikearsimore |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 12 | Brusa studimi<br>Transport për 70 fëmijë Drizë/Mbrostar<br>Kampe verore (2 javore)<br>Kurse profesionale | Fëmijë dhe të rinjtë nga grupet e disavantazhuara | Qendra Murialdo | Projekte donatoresh/Fonde te vetat | Bashkëpunime per aplikime te përbashkëta në projekte |

### 2.4.4 Financimi i shërbimeve aktuale

Shpenzimet totale të Bashkisë Fier shënuan rritje për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021. Gjatë vitit 2022, shpenzimet totale u rritën 178,006,000 Lekë ose me rreth 8.3% në terma vjetorë ndërsa rritja gjatë vitit 2023 ishte me 115,956,000 Lekë ose 5% të vitit të mëparshëm. Sipas funksioneve të qeverisjes, shpenzimet që kanë pasur rritje domethënëse janë arsimi parashkollor dhe bazë, 'zhvillimi i komunitetit' dhe 'shërbinet kulturore'. Zëri 'mbrojtja sociale' në vitin 2022 u rrit me vetëm 1,004,000 Lekë ose 4 % të vitit të mëparshëm ndërsa nuk ndryshoi gjatë 2023.

*Tabela 12: Fondi Social Qendror dhe Vendor në Bashkinë Fier*

| Kategoritë | | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|---|
| Bashkia Total(000 Lekë) | | 2,596,496 | 2,859,400 | | |
| Bashkia Fondi Social Vendor (000 Lekë) | | 10,000 | 10,000 | | |
| MSHMS (Fondi Social Qëndror | - | 8,342 nga 24,705 për 36 muaj) | 8,631 nga 24,705(për 36 muaj) | | |
| Fonde të Shpenzuara për Shërbime Sociale nga Organizata/Programe Donatore | | UNDP Romacted TdH | UNDP Romacted TdH | UNDP Romacted TdH (Të Rinjtë) | UNDP Romacted TdH |

*Burimi: Bashkia Fier*

Bashkia ka rritur gradualisht fondin social vendor nga 5,000,000 në 2021 dhe 7,500,000 në 2022 dhe prej 2023 e në vijim në 10.000.000 lekë për shërbime sociale për fëmijët, komunitetet, gratë, moshën e tretë etj. Krahas këtij fondi, buxheti përmban edhe zëra të tjerë që kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve të përkujdesit social ku futen përmirësimet infrastrukturore por që nuk janë lehtësisht të identifikueshme pasi janë pjesë e zërave të tjerë buxhetorë. Fondi Social Vendor prej 10,0000,000 lëkësh mbulon këto kategori shpenzimesh: për ndihma financiare të menjëhershme, paketa ushqimore, shpenzime trajnimesh për stafin përgjegjës për dhunën, fëmijët, aftësinë e kufizuar në shkallë kombëtare, si dhe fushata sensibilizuee.

*Tabela 13: Ndarja e përqindjes së fondeve të projektit të Fondit Social në Bashkinë Fier 2023-2025*

| | | Fondi/MSHMS | Bashkia | TdH |
|---|---|---|---|---|
| Viti 1 | 8,342,320.92 | 57% | 4% | 39% |
| Viti 2 | 8,631,120.92 | 36% | 24% | 40% |
| Viti 3 | 7,732,120.92 | 20% | 50% | 29% |
| **Totali** | **24,705,562,8** | | | |

*Burimi: Bashkia Fier*

Fondi Social Qendror prej 24,705,562.8 lekë është mobilizuar në bashkëpunim midis Bashkisë Fier dhe organizatës Terres des Hommes për tre vjet 2023-2025 (36 muaj) ose afërsisht 8,000,000 Lekë në vit. Organizata donatore që kanë ushtruar veprimtari në territorin e bashkisë Fier në fushën e shërbimeve sociale janë: BE (ARCHEOS) në fushën e kulturës, Terres des Hommes (Riintegrim i Qëndrueshëm Socio-Ekonomik për të Rikthyerit), UNDP (Askush të mos mbetet pas), KiE dhe IRCA (Romacted).

Siç vihet re, ka pasur një rritje të buxhetit për shërbimet sociale ku krahas fondit social qëndror, bashkia ka celur edhe fondit social vendor. Qeveria qendrore duke qenë ofruesi më i madh i shërbimeve sociale nëpërmjet programeve të ndihmës dhe përkujdesit shoqëror, arsimimit dhe kujdesit shëndetësor ka edhe përgjegjësinë për të mbikëqyrur zbatimin e politikave sociale.

| | *Tabela 14: Buxheti i parashikuar për periudhën 2024-2026 000 / LEKE* | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Burimet e Financimit** | **Fakti 2022** | **Plani 2023** | **Parashikim 2024** | **Parashikim 2025** | **Parashikim 2026** |
| 1 | Të ardhura të trashëguara nga viti i kaluar | 116,363 | 476,667 | 908,464 | 910,287 | 911,947 |
| 2 | Të ardhura nga taksat dhe tarifat | 732,158 | 822,750 | 889,876 | 889,876 | 889,876 |
| 3 | Transferat specifike | 354,390 | 402,079 | 432,809 | 432,809 | 432,809 |
| 4 | Transferta e pakushtëzuar | 567,008 | 738,018 | 250,000 | 0 | 0 |
| | **Të ardhura gjithësej** | **1,769,919** | **2,439,514** | **2,481,150** | **2,232,972** | **2,2234,632** |

*Burimi: Bashkia Fier*

Sipas relacionit të Planit Buxhetor Afatmesëm Buxheti, për tre vitet e ardhshme parashikohet rritja e të ardhurave, rritja e shërbimeve, rritja e aksesit dhe të cilësisë së jetës në qytet dhe në zonat rurale të të Bashkisë Fier. Rritja e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore do të shoqërohet me forcimin e kapaciteteve administruese. Ndër të tjera do të merret në konsideratë edhe lehtësimi i proçedurave në marrëdhënie me subjektet dhe familjarët dhe adresimin e faktorëve që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve.

### 2.4.5 Strukturat që mbështesin apo ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë Fier

**Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier**

Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror rrjedhin nga Ligji 121/2016 "Për shërbimet e për kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", në nenin 33 të titulluar "Roli i Shërbimit Social Shtetëror". Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror kanë përgjegjësi të veçanta, të cilat përfshijnë:

a. Hartimin e dokumentacionit standard për përfituesit e shërbimeve shoqërore;

b. Kryerjen e vlerësimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror;

c. Mbledhjen, analizën dhe përpunimin e informacionit për ecurinë e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe raportimin periodik në Ministrinë e përgjegjës për çështjet sociale;

d. Hartimin e raportit vjetor të vlerësimit të nevojave dhe kapaciteteve të shërbimeve publike dhe jopublike të kujdesit shoqëror;

e. Trajnimin e personelit të njësive të qeverisjes vendore për aspektet e shërbimeve shoqërore;

f. Bashkërendimin e procesit të hartimit të planeve sociale për të siguruar që ato të përputhen me strategjitë kombëtare;

g. Përditësimin dhe mirëmbajtjen e Regjistrit Elektronik Kombëtar me të dhënat për përfituesit dhe subjektet kërkuese të kujdesit shoqëror;

h. Dërgimin e statistikave sociale të lidhura me shërbimet e kujdesit shoqëror dhe pagesat sociale në Ministrinë përkatëse.

Këto detyra dhe përgjegjësi sigurojnë që Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror të funksionojë efektivisht dhe të kontribuojë në ofrimin e shërbimeve të nevojshme për komunitetin në nivel lokal dhe kombëtar.

**Drejtoria e Shërbimit Social në Bashkinë Fier**

Nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimit Social, Bashkia Fier ushtron rolin e saj vendimarrës dhe administrativ lidhur me nevojat e ndryshme të komunitetit, duke përfshirë personat në nevojë (NE), personat me aftësi të kufizuara (PAK) dhe shërbimet shoqërore të tjera. Drejtoria e Shërbimit Social kryen funksionet e saj bazuar në Ligjin 121/2016, në nenin 36 "Roli i bashkisë" dhe nenin 37 "Roli i punonjësit social të njësisë së qeverisjes vendore". Bashkia ofron dhe administron shërbimet e kujdesit shoqëror brenda territorit të saj duke identifikuar nevojat në mënyrë të mëposhtme:

a) Vlerëson nevojat duke u bazuar në hartën e vulnerabilitetit;
b) Harton planin social vendor;
c) Programon buxhetet vendore;
d) Planifikon shportën bazë të shërbimeve shoqërore;
e) Kontrakton ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror duke zbatuar procedurat e prokurimit sipas legjislacionit për prokurimin publik;
f) Bashkërendon me Shërbimin Social Shtetëror për shërbimet e nevojshme të kujdesit shoqëror.

Bazuar në ligjin përkatës, shërbimet që ofrohen nga Bashkia Fier për grupet në nevojë janë specifikuar në seksionin 2.4.3 më sipër. Gjithashtu, për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror pranë Bashkisë Fier janë themeluar struktura të posaçme si "Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës" dhe "Njësia për barazinë gjinore dhe dhunën në familje".

**Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës**

Në Bashkinë Fier është themeluar dhe operon Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, e cila ka përgjegjësi për:

a) Vlerësimin e informacionit për fëmijën në rrezik dhe nivelin e rrezikut;
b) Vlerësimin e nevojave të fëmijës dhe familjes;
c) Monitorimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve viktima të dhunës, abuzimit dhe keqtrajtimit;
d) Koordinimin e funksionimit të Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN);
e) Bashkëpunimin me çdo strukturë përgjegjëse për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

f) Organizimin e takimeve informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës;
g) Evidentimin e nevojave përmes vlerësimit të gjendjes sociale-ekonomike reale;
h) Funksionimin si qendër informacioni.

Punonjësit e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës në njësitë administrative të Bashkisë janë pjesë e Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NjVNR) dhe kryejnë vetëm detyra që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve.

**Njësia për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje**

Njësia për barazinë gjinore dhe dhunën në familje në Bashkinë Fier operon në bazë të Ligjit Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" (të ndryshuar), në nenin 7 që rregullon detyrat dhe përgjegjësitë e autoritetit përgjegjës. Në përputhje me këtë ligj, njësia për barazinë gjinore ka përgjegjësitë e mëposhtme:

a) Lehtëson dhe mbështet bashkëpunimin e organeve të qeverisjes vendore me institucionet lokale për barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës në familje;
b) Siguron ekspertizë teknike për bashkinë për çështje të barazisë gjinore dhe për marrjen e masave për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje;
c) Mbështet organet e qeverisjes vendore dhe lehtëson bashkëpunimin e tyre të ngushtë me organizatat jofitimprurëse lokale dhe organismat akademikë për të promovuar barazinë gjinore në fusha të ndryshme dhe për të zhvilluar programe mbrojtëse për viktimat e dhunës në territorin që ato mbulojnë;
d) Bashkëpunon me strukturat përkatëse në ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe asiston organet e qeverisjes vendore në mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e statistikave vendore të ndara sipas gjinisë, duke u bazuar në format e miratuara nga autoriteti përgjegjës;
e) Inicion dhe merr pjesë aktive në aktivitetet dhe fushatat ndërgjegjësuese për barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës në familje, të organizuara nga bashkia ose në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për barazinë gjinore dhe shoqërinë civile (p.sh., takime, seminare, diskutime në media);

f) Përgatit informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për të pasqyruar çështjet gjinore në faqet e internetit, buletinet ose mjete të tjera të informimit të bashkisë.

Në bashkëpunim me UNDP, është hartuar edhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës në Familje, i cili ka ofruar udhëzimet dhe strategjitë për funksionimin e kësaj njësie në përputhje me standardet dhe objektivat e vendosura.

**Njësia për vlerësimin e nevojave dhe referimit (NJVNR**)

Njësia për Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NJVNR) përbëhet nga përfaqësues të sektorit të pagesave (ndihma ekonomike, pagesa për aftësi të kufizuara, etc.) dhe sektorit të përkujdesit social (shërbimet sociale në komunitet, rastet e dhunës në familje, rastet e abuzimit dhe problematikat e fëmijëve). Ngritja e kësaj njësie në nivelin e Bashkisë dhe në nivelin e Njësive Administrative jo vetëm që është një detyrim ligjor, por gjithashtu përfaqëson strukturën themelore për identifikimin dhe referimin e problematikave të grupeve në nevojë drejt strukturave të përshtatshme për zgjidhjen e tyre. Funksionimi i plotë i NJVNRsë në të dy nivelet ka një ndikim të drejtpërdrejtë në zbatimin e gamës së

shërbimeve sociale, në reduktimin dhe lehtësimin e varfërisë, si dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjitha grupet në nevojë, duke përfshirë ato që janë përfshirë në Planin Vendor të Kujdesit dhe Përshirjes Sociale.

**Komisioni i Strehimit në Bashki**

Për hartimin dhe zbatimin e programit të strehimit social, si dhe për menaxhimin e sektorit të strehimit social, në Bashkinë Fier angazhohet Komisioni i Strehimit, i përbërë nga 9 anëtarë, dhe 7 role të konfiguruara në sistemin online të banesave sociale. Në zonat urbane të Fierit, zbatimi i programeve të strehimit social është themelor për zhvillimin qëndrueshëm të komunitetit, pasi që ul pabarazitë dhe mundëson trajtimin e grupmoshateve të ndjeshme me kushte më të mira strukturore, shëndetësore dhe sanitarë në banesa. Në të kundërt, në zonat rurale, disa nga sfidat që mund të përballen këto njësi administrative janë:

a) Kalimi i të drejtave të pronësisë, i cili kërkon ndërhyrjen e pushtetit qendror.
b) Cilësia e dobët strukturore e banesave, që mund të jenë në rrezik shembjeje.
c) Kushtet shëndetësore dhe sanitarë të banesave që janë më të ulëta.
d) Aksesi i kufizuar në shërbimet publike dhe sociale.

Sipas Planit të Planifikimit Vendor, i cili është në proces, Bashkia Fier ka parashikuar një zonë për sigurimin e banesave sociale, konkretisht një pronësi toke me sipërfaqe 2320 m2, nga të cilat 454 m2 janë të ndërtesës, e vendosur në Zonën Kadastrale 8533. Në bazë të kushteve zhvillimore, në këtë pronësi pritet të ndërtohet një kompleks banesash me një sipërfaqe prej 2786 m2, i zhvilluar në 4 kate, me planifikim për të ndarë 43 apartamente me një dhomë gjumi dhe një kuzhinë.[52]

*Tabela 15: personelit ne strukturat pergjegjese per sherbimet sociale ne bashki/njësi administrative*

| Struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit/përfshirjes sociale në Bashkinë Fier | Sipas organikës | Sipas faktit |
|---|---|---|
| Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashkinë Fier | 1 | 1 |
| NJVNR/Bashki | - | |
| NJVNR/Njësi Administrative | - | |
| NJMF/Bashki | 1 | 1 |
| NJMF/Njesi Administrative | - | |
| Njësia për PAK | 1 | 1 |
| Njësia për NE | 13 | 13 |
| Njësia për Dhunën | 1 | 1 |
| Njësia për Trafikimin | - | |
| Qender Komunitare Drizë | - | |
| Qendër Komunitare Levan | 1 | |
| Qendër Komunitare Fier/tek Banesat Sociale | 7 | 3 |
| **Totali** | **25** | **20** |
| *Burimi: Bashkia Fier* | | |

[52] Shih, Planin Vendor të Strehimit Social 2023-2028.

Në webfaqen e Bashkisë Fier është publikuar organigrama e vitit 2022, po nderkohe qe nga burime zyrtare prane bashkise Fier eshte vene ne dispozicin organograma e re e cila përfshin ndër të tjera tetë drejtori, të cilat ndër të tjera mbulojnë taksat dhe tarifat, shërbimet publike, shërbimet sociale, financën, burimet njerëzore, cështjet ligjore, administrimin e aseteve bujqësore, si dhe emergjencat civile. Vihet re se Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka një mungesë stafi prej të paktën 5 vetësh ndërkohë që ende nuk janë ngritur ne te gjitha njesit administrative NJVNR-të në nivel bashkie dhe Njësie Administrative.

Gjithashtu, krahas kryetarit të bashkisë, organika përfshin kater Zv/Kryetarë, të cilët ndajnë përgjegjësitë mbi drejtori të caktuara, dhe 13 administratorët e njësive administrative. Sipas informacionit të publikuar në Webfaqe, Këshilli Bashkiak është i organizuar në shtatë komisione, përfshirë edhe Komisionin për Çështjet Sociale. Aty gjendet edhe rregullorja e Këshillit Bashkik e miratuar në 27/01/2017 ndërsa vendimet e Këshillit Bashkiak prej 2007 e në vijim janë të publikuar në platformën e Arkivës Kombëtare të Vendimeve të Këshillave Bashkiakë të Shqipërisë vendime.al, e cila është e aksesueshme përmes webfaqes së bashkisë.

**Organizatat e Shoqërisë Civile që ofrojnë shërbime të përkujdesit social në Bashkinë Fier**

**Qendra Sociale Murialdo** vepron në Fier prej vitin 1995 në fusha të ndryshme duke përfshirë trajnimin profesional, arsimin, rekreacionin dhe përfshirjen sociale të të rinjve kryesisht nga grupet e disavantazhuar. Qendra ofron shërbime për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve nëpërmjet aktiviteteve psiko-sociale, mbështetjes shkollore dhe aftësimit profesional.

**Organizata "Terre des Hommes**", ofron shërbime komunitare, mbështetje psiko-sociale, ligjore dhe ekonomike për fëmijët dhe familjet e tyre, duke bashkëpunuar me autoritetet përkatëse. Kjo organizatë operon që prej vitit 2006, vit në të cilin ka ngritur NJMF në Bashkinë Fier. Gjithashtu organizata ofron shërbime për integrimin e fëmijëve dhe familjeve në nevojë të kthyera nga emigracioni ose në rrezik migrimi. TdH gjithashtu bashkëpunon me Bashkinë Fier në operimin e Qendrës Komunitare Multifunksiola tek banesat sociale, e cila ka në fokus fëmijë të fshatit Drizë, por jo vetëm dhe ofron shërbime për të gjithë fëmijët në situtata të vështira sociale dhe ekonomike.

**Qendra Epoka e Re** është një qendër rinore që punon me të rinjtë e moshës 14 deri në 29 vjeç që nga viti 2005 për të adresuar nevojën që të rinjtë të vetëorganizohen, të bëhen pjesë aktive e komunitetit të tyre si agjentë për ndryshim.

**Zëri Rom - Voice of Roma**, ofron mbështetje për familjet rome nëpërmjet projekteve të ndryshme, kryesisht në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe fuqizimin e familjeve rome.

**Qendra "Platforma Kombetare per Grate"** eshte nje organizat jo fitimeprurese qe ofrone sherbime psikologjike ,psikosociale dhe keshillime ligjore per familjet dhe persona ne nevoje me specter te ndryshem problematikash.

**Bashkë për Integrimin e Komunitetit Rom - Together for Integration of Roma Community (TIRC)**, ofron mbështetje në fushën e bujqësinë për fuqizimin e fermerëve rom.

Deri vitet e fundit, në Fier kanë zbatuar projekte edhe organizata të tjera si "Save the Children", Fondacioni "Ndihmë për Fëmijët", Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri - IRCA, etj.

Si pjesë e shoqërisë civile funksionojnë edhe shoqatat të cilat kryejnë aktivitete advokuese për grupe të ndryshme interesi, siç janë fëmijët pa kujdes prindëror, personat me aftësi të kufizuar, invalidët etj. Megjithatë, veprimtari e tyre në Bashkinë Fier mbetet shumë e kufizuar.

### 2.4.7 Listën e shërbimeve shoqërore të munguara në territorin e Bashkisë Fier

Gjatë tryezës konsultative të zhvilluar ne Shkurt 2026, grupi i punës dhe përfaqësues nga institucionet dhe organizatat partnere identifikuar mungesat në shërbimet e mëposhtme:

- Shërbimi i qendrave ditore për të moshuarit
- Shërbimi në familje për të moshuarit e vetmuar
- Sherbimet levizeze per kategori ne nevoje
- Sherbime per familje kujdestare
- Shërbimi strehimi emergjent 72 orësh dhe përkujdesjeje për fëmijët të braktisur, të cilët shfrytëzon në rrugë apo janë viktima apo në rrezik trafikimi (aktualisht referohen në Tiranë).
- Programe për viktimat e dhunës në familje përfshirë strehimit emergjent 72 orësh (aktualisht referohen në Vlorë)
- Shërbime rehabilituese dhe zhvilluese për fëmijë me aftësi të kufizuara
- Sherbime ne familje per femijet me aftesi te kufizuar
- Shërbime këshillimi dhe terapeutike mbi shëndetin mendor që paraqet cenon sigurinë publike
- Shërbime këshillimi dhe terapeutike mbi varësitë nga akooli dhe droga
- Sherbime per riintegrimin e femijeve ne konflikt me ligjin
- Mungesa e NJVNR
- Mungesa e theksuar e burimeve njerezore prane Bashkise Fier per mbrojtjen e femijeve dhe dhunen ne familje

## 2.5 Analiza SWOT

**Pikat e Forta**

1. **Personel i strukturës përgjegjëse i përkushtuar dhe i dedikuar** në ofrimin e shërbimeve sociale ndaj individëve, familjeve, dhe komuniteteve të veçanta në nevojë.

2. **Lidershipi dhe drejtuesit** e strukturave të shërbimeve sociale të Bashkisë Fier të angazhuar në përmirësimin e zbatimin të kuadrit ligjor mbi shërbimet e kujdesit shoqëror dhe mbështetjen e pëfshirjes sociale.

3. Bashkëpunim përgjithësisht i mirë institucional midis bashkisë dhe **strukturave në varësi të ministrive** përgjegjëse për arsimin, formimin dhe punësimin, strehimin, shëndetin publik, ndihmën ligjore falas, shërbimin e provës, mbrojtjen sociale, sigurinë dhe rendin si dhe Prefekturës Fier dhe Këshillit të Qarkut.

4. Bashkëpunim i afërt midis strukturave të shërbimeve sociale në bashki dhe **organizatave dhe programeve** të shoqërisë civile aktive në ofrimin e shërbimeve dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut (veçanërisht, Qendra Murialdo, Qendra Epoka, Terres des Hommes-TdH, Voice of Roma in Albania-VRA, dhe Together for Integration of Roma Community-TIRC).

**Pikat e Dobëta**

1. **Mungesa e statistikave dhe evidencave** mbi zbatimin e planeve të mëparshme institucionale të Bashkisë Fier që synojnë kujdesin dhe përfshirjen sociale. Përveçse raportit të vlerësimit nga Shërbimi Shtetëror Social dhjetor 2023, nuk ka raporte vjetore nga Bashkia Fier mbi ecurinë e zbatimit të planeve vendore.Mungesa e të **dhënave të përpunuara (saktë dhe besueshëm) mbi grupet e interesit në nevojë për shërbime sociale** vështirëson hartimin e politika vendore dhe matjen e treguesëve të ndërhyrjeve të realizuara sipas Planit Vendor Social.

2. **Mungesa e shërbimeve për disa kategori në nevojë.** Mungesa e shërbimeve rezidenciale apo gjysëm-rezidenciale për fëmijët e braktisur apo në situatë rruge. Rastet e këtyre fëmijë referohen dhe trajtohen në Tiranë; Mungesa e shërbimit në familje për të moshuarit e vetmuar; Mungesa e shërbimeve mbështetëse psiko-sociale lidhur me problematikat e shëndetit mendor, të cilat mund të përbëjnë rrezik për sigurinë publike. Evidentimi i këtyre rasteve realizohet përmes strukturave të policimit në komunitet; Mungesa e shërbimeve psiko-sociale rehabilituese për individët të cilët vuajnë nga varësitë e ndryshme (alkoholi, droga, lojrat e fatit, etj.) Mungojnë shërbime komunitare për personat me aftësi ndryshe.

3. Pavarësisht marrëdhënieve të mira ndërinstitucionale, **bashkia Fier nuk ka mobilizuar mjaftueshëm fonde nga programet qeveritare të tilla si Fondi Social, Strehimi, Punësimi**. Mungon personeli i kualifikaur në përgatitjen e aplikimeve për këto fonde.

4. Mungon një **mekanizëm informimi dhe përditësimi periodik mbi ndërhyrjet, programet apo projektet** në fushën e kujdesit dhe përfshirjes sociale, të cilat zbatohen nga organizatat dhe institucionet partnere.

5. **Mungesa në burime njerëzore** të specializuar dhe trajnuar për shkrim dhe menaxhim projektesh, të cilat mund të mobilizojnë fonde nga skemat e qeverisjes qendrore dhe donatorë vendas e të huaj.

6. **Buxhet shumë i ulët për shërbime të kujdesit shoqëror.** Fondi zakonisht mbulon pako ushqimore; transport për fëmijët me aftësi të kufizuar në Qendrën Horizont; fondi vjetor për strehim social; fonde për shërbimin në Shtëpinë e të Moshuarve).

7. **Mungesë informacioni dhe akses i kufizuar në shërbimet publike dhe sociale** (shërbimet e kujdesit social, programet e strehimit social, programet e punësimit, etj.), **shtuar edhe për shkak të digjitalizimit** të shërbimeve për të cilat nevojitet ndihmë në bërjen e aplikimeve në e-Albania dhe përgatitjen e dokumentacionit.

8. **Planifikimi afatshkurtër dhe i pakoordinuar i ndërhyrjeve** që synojnë përfshirjen sociale të komuniteteve rome dhe egjiptiane kanë rezultuar në projekte të fragmentuara dhe të paqëndrueshme, të cilat kanë sjellë përmirësime të papërfillshme të situatës ende larg pikës së ndryshimit të trendeve të varfësisë prej disa gjeneratash apo të mbijetësës së informalitet të

këtyre familjeve. Raporti i monitorimit thekson edhe mungesën e kapaciteteve të trajnuar me problematikat e zbatimit dhe përpunimit të të dhënave mbi pakicat rome dhe egjiptiane, të ende përballen me diskriminim dhe përjashtim social.

9. **Mungese e theksuar stafi ne pjesen e sherbimeve sociale** duke mos permbushur as kriteret ligjore te nevojeshme per ngritjen e NJVNR ne njesite administrative dhe as duke plotesuar me staf pjesen e njesise per mbrojtjen e femijeve duke mare parasyshe detyrimet ligjore nga ligji 18/2017 per mbrojtjen dhe t edrejtat e femijeve dhe nga detyrimet qe vijne si pasoje e zbatimit te kodit te procedures penale per te mitur.

**Mundësitë**

1. Një **bashki me potenciale ekonomike** avantazhuese krahasuar me qytete të tjera, veçanërisht në fushën e tregtisë, bujqësisë, turizmit bregdetar dhe arkiologjik.

2. Disa prej reformave legjislative të ndërmarra dhe programeve qeveritare në zbatim të tyre përbëjnë jo vetëm një udhërrëfyes por edhe **burime të mundshme financime dhe bashkëfinancimi** për punën e bashkisë në adresimin e mbrojtjes sociale, strehimit, formimit e punësimit, shërbimeve të specializuara si ndihma ligjore, ndihma psiko-sociale, etj.

3. Prezenca ende e lartë e organizatave dhe agjensive të huaja donatore dhe së fundmi **miratimi nga BE-ja i Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor** përbën një potencial për mobilizimin e fondeve me qëllim zbatimin e programeve parandaluese dhe atyre fuqizuese të familjeve me nevoja të veçanta. Mundësitë që burojnë nga angazhimet ndërkombëtare të vendit tonë si dhe nga procesi i anëtarësimit në BE dhe përafrimi i kuadrit ligjor.

4. **Ekspertiza dhe përvoja e një pjese të personelit përgjegjës** për shërbimet sociale në Bashki së bashku me praktikat premtuese dhe pozitive të zbatuara në vite.

5. **Ekspertiza, përvoja dhe praktikat pozitive që kanë organizatat e shoqërisë civile** që veprojnë në territorin e bashkisë Fier (kryesisht, Qendra Murialdo, Qendra Epoka, Terres des Hommes-TdH, Voice of Roma in Albania-VRA, dhe Together for Integration of Roma Community-TIRC).

6. **Drejtuesit dhe personeli përgjegjës për shërbimet sociale në Bashkinë e Fierit tregojnë gatishmëri për të bashkëpunuar** me organizata partnere kombëtare dhe ndërkombëtare.

**RREZIQET**

1. **Nevoja në rritje për shërbime** si pasoje e mungesës së programeve efektive parandaluese çon në rritjen e numrit të individëve/familjeve në nevojë për shërbime sociale.

2. **Mobilizimi i ultët i burimeve financiare** cenon zbatimin e programeve efektive për përfshirje sociale dhe fuqizimin e përfituesëve të shërbimeve, duke krijuar varësi thuajse të përhershme nga këto shërbime.

3. **Problemet social-ekonomike të popullatës kryesisht rurale** që kanë qenë jashtë territorit të Bashkisë, ende nuk njihen mjfatueshëm dhe për rrjedhojë të neglizhohen.

4. **Ndryshimi i drejtuesëve dhe personelit të strukturave përgjegjëse në Bashki** ka nevojë për kualifikim fillestar dhe të vazhdueshëm të stafit.

**Rekomandime**

- Rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve të strukturave të shërbimeve sociale për të ofruar ndihmë dhe mbështetje më efikase dhe cilësore për individët, familjet, dhe komunitetet në nevojë në territorin e Bashkisë Fier.

- Rritja e financimit dhe efikasitetit të shërbimeve të kujdesit dhe përfshirjes sociale, duke integruar programe efektive parandaluese dhe fuqizuese për individët, familjet dhe komunitetet në nevojë në territorin e Bashkisë Fier.

- Përmirësimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional për raportimin, monitorimin dhe vlerësimin vjetor të 'Planit Vendor të Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale'.

# 3. VIZIONI, QËLLIMET, OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

## 3.1 Vizioni i Bashkisë Fier

Në zbatim të misionit të saj të përcaktuar mbi bazën e kuadrit ligjor dhe të politikave kombëtare mbi kujdesin dhe përshirjen sociale, "Bashkia Fier synon që në territorin e saj çdo individ, familje dhe komunitet në nevojë të mundësohet të aksesojë një sistem vendor ndërsektorial, të mirëfinancuar, dhe efikas të shërbimeve të kujdesit dhe përfshirjes sociale, i cili synon fuqizimin dhe integrimin e grupeve më të pafavorizuara. "

## 3.2 Sfidat Kryesore

Bashkia Fier është e përkushtuar për të adresuar sfidat kryesore që lidhen me realizimin e vizionit të saj. Këto sfida përfshijnë rritjen e kapaciteteve institucionale të strukturave përgjegjëse, përmirësimin e financimit dhe efikasitetit të shërbimeve sociale dhe programeve të fuqizimit komunitar, si dhe nxitjen e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional me institucionet dhe organizatat donatore e ato të shoqërisë civile.

Duke ndërmarr masat e parashikuara në këtë Plan, Bashkia Fier synon t'u japë përparësi grupëve më të pafavorizuara, duke përfshirë familjet në skemën e ndihmës ekonomike, fëmijët pa kujdes prindëror dhe/ose në rrezik për shfytëzim dhe trafikim, personat me aftësi të kufizuar dhe invalidë, familjet e pastreha, viktimat e dhunës në familje, të moshuarit e vetmuar, komunitetet rome dhe egjiptiane, si dhe të rikthyerit nga proceset e azil-kërkimit ose emigracioni i pasuksesshëm.

## 3.3 Qëllimet, Objektivat, dhe Aktivitetet

**Qëllimi 1: Rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve të strukturave të shërbimeve sociale për të ofruar ndihmë dhe mbështetje më efikase dhe cilësore për individët, familjet, dhe komunitetet në nevojë në territorin e Bashkisë Fier**

**Objektivi 1.1: Plotësimi me staf i strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale dhe ngritja e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit.**

**Aktivitetet:**

1.1.1 Plotësimi me staf i sektorit të Mbrojtjes dhe Përkujdesit Sociale/Ngritja e Njësisë të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në Bashki

1.1.2 Ngritja e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në Njësitë Administrative

1.1.3 Përmirësimi i infrastrukturës së punës (mjedise pune, laptop, telefon shërbimi) të strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki dhe NJA

**Objektivi 1.2: Rritja e njohurive dhe aftësive profesionale të strukturave të shërbimeve të kujdesit shoqëror për të përmbushur cilësisht detyrat funksionale**.

1.2.1 Përgatitja e një pakete orientuese për drejtuesit dhe personelin e ri të strukturave të kujdesit dhe shërbimeve sociale

1.2.2 Organizimi i vizitave studimore në bashki me përvojë në fushën e shërbimeve sociale dhe programeve fuqizuese komunitare në vend dhe në rajon

1.2.3 Trajnime të stafit të Sektorit të Mbrojtjes dhe Përkujdesjes Sociale në Bashki mbi kuadrin ligjor, praktikat e punës dhe marrdhëniet me publikun në përputhje me misionin me vizionin e Bashkisë

1.2.4 Trajnime të ekipeve që menaxhojnë rastet sociale (Nj.V. N. R., NJMF, Koordinatori për masa kundër dhunës në familje, administratorët shoqëror, etj.) mbi mjetet dhe praktikat e menaxhimit të koordinuar të rastit

1.2.5 Trajnime për personelin e sektorit përgjegjës në fushat e hartim-zbatim-vlerësim projektesh dhe ngritjen e fondeve

**Qëllimi 2: Përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimeve të kujdesit dhe përfshirjes sociale, duke integruar programe efektive parandaluese dhe fuqizuese për individët, familjet dhe komunitetet në nevojë në territorin e Bashkisë Fier**

**Objektivi 2.1: Informimi publik, identifikimi proaktiv i individëve në nevojë për shërbime, dhe ndihmë e drejtëpërdrejtë në përgatitjen e dokumentacionit dhe aksesimin e shërbimeve dhe programeve sociale, duke përfshirë, por pa u kufizuar te ato të digjitalizuara.**

2.1.1 Materiale informuese mbi egzistencën e shërbimeve dhe programeve dhe mënyrat e aksesimit të tyre

2.1.2 Përditësimi i vazhdueshëm i seksionit mbi mbrojtjen sociale si pjesë e webfaqes së Bashkisë

2.1.3 Organizimi i panairit për shërbimet sociale dhe programet komunitare, duke integruar takime komunitare për ndërgjegjësim dhe informim mbi të drejtat dhe shërbimet, si dhe ofrimin e ndihmës së drejtëpërdrejtë për aksesimin e shërbimeve

2.1.4 Trajnim i Kryetarëve të Njësive Administrative, koordinarëve komunitar të rajoneve dhe kryetarëve të fshatrave për identifikimin dhe referimin e rasteve të individëve në nevojë për shërbime

2.1.5 Referim për ofrimin e ndihmës ligjore parësore për përgatitjen e dokumentacionit dhe asistencën aktive për të aksesuar shërbimet, duke përfshirë, por pa u kufizuar tek ato të digjitalizuara.

**Objektivi 2.2: Krijimi i një sistemi efikas dhe të financuar mirë për menaxhimin e koordinuar të rasteve të individëve, familjeve, dhe komuniteteve në nevojë për shërbime të emergjencës, rehabilituese, zhvillimore dhe riintegruese.**

**Aktivitetet:**

2.2.1 Përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimeve/programve për fëmijën dhe familjen në nje Qender Komunitare Multifunksionale Bashkia Fier në Banesat Sociale duke angazhuar psikologë dhe punonjës social të kualifikuar për të ofruar:

1. *Këshillim për prindërimin e mirë*
2. *Programe mbështetëse pas-shkolle (after-school) për nxënësit e arsimit të detyruar*
3. *Programe mbi aftësimin jetësor të të rinjve (life skills)*
4. *Ndihmë ligjore parësore falas, duke përfshirë, por pa u kufizuar tek dhënia e ndihmës për aksesimin e shërbimeve në e-albania (për tu ngritur)*
5. *Këshillim kariere dhe punësimi për të rinjtë dhe familjet rome/egjiptiane, familjet e rikthyera nga emigracioni, dhe familjet në ndihmë ekonomike (për tu ngritur)*
6. *Këshillim psikosocial për personat me varësi nga alkoolit/drogave, pjesëtarët e familjeve që kanë përjetuar divorc, individët me probleme të shëndetit mendor, viktimat e dhunës në familje dhe çdo individ në nevojë (për tu ngritur)*
7. *Shërbime në familje për personat me aftësi të kufizuara që e kanë të pamundur të kujdesen për veten e nuk mund të ndihmohen nga familjaret apo ndihmësi personal (për tu ngritur)*

2.2.2 Përmirësimi (identifikimi, referimi dhe ndjekja e procedurave për përfitimin e kujdestarisë ligjore të të miturve pa kujdes prindëror

2.2.3 Përmirësimi (identifikimi, referimi dhe shoqërimi tek qendrat rezidenciale) i shërbimit të kujdesit për fëmijët viktima të trafikimit dhe/ose pa kujdes prindëror

2.2.4 Shërbimi i strehës së emergjencës 72 orë për viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët (për tu ngritur)

2.2.5 Përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimeve për të moshuarit

1. *Shtimi dhe përmirësimi i ambjenteve të Shtëpisë së të Moshuarëve në Fier*
2. *Shtimi dhe trajnimi i stafit të Shtëpisë së të Moshuarve*
3. *Ngritja e shërbimeve (kafe/çaj, internet, gazeta për të paktën 40 të moshuar) pranë Qendrës Ditore për moshën e tretë (për tu ngritur)*
4. *Shërbime në familje (kryerja e blerjeve javore, shërbim infermieror, shërbim higjeno-sanitar) për të moshuarit e vetmuar (për tu ngritur)*

2.2.6 Vazhdimi dhe përmirësimi i shërbimeve për personat me aftësi ndryshe në Qendrën Horizont

*1. Shërbimi ditor për fëmijët me aftësi ndryshe 6 – 21 vjeç*

*2. Shtimi i stafit të kualifikuar*

*3. Shërbime shtesë të integruara në fushën e arsimit dhe punësimit (për moshën 19-21 vjeç)*

2.2.7 Përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimeve ligjore falas për të gjitha individët, familjet, dhe komunitetet e disavantazhuara duke përfshirë, por pa u kufizuar tek familjet në ndihmë ekonomike, familjet e rikthyera nga proceset azilkërkuese apo emigracioni i pasuksesshëm, familjet rome dhe egjiptiane dhe çdo individ tjetër në nevojë:

1. *Identifikimi proaktiv i rasteve në nevojë dhe dhënia e ndihmës ligjore parësore edhe në përgatitjen e dokumentacionit për shërbime sociale dhe aksesimin e platformës e-albania.*
2. *Identifikimi proaktiv i rasteve në nevojë dhe dhënia e ndihmës ligjore dytësore për ndjekjen e të gjitha proceseve gjyqësore*

2.2.8 Referimi dhe ndjekja e menaxhimit të rasteve pranë Qendrës së Emergjencës për Viktimat e Mitur të Dhunës Seksuale, ngritur me mbështetjen e UNICEF-it pranë Spitalit Rajonal Fier

2.2.9 Bashkërendimi i veprimeve me institucionet shëndëtësore për ofrimin e shërbimeve terapeutik ambulator për personat me probleme të shëndetit mendor dhe personave me varësi nga alkooli dhe droga.

2.2.10 Përmirësimi/ndërtimi i rampave në të gjitha institucionet publike dhe transportit publik brenda territorit të Bashkisë Fier për t'i bërë të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara

2.2.11 Trajtimi sipas rastit me bonus qiraje, banesë sociale ose lehtësimi i procedurave për rikonstruksion banese i familjeve rome/ egjiptiane, familjeve në nevojë të cilat janë rikthyer nga emigracioni i pasuksesshëm, dhe familjeve në ndihmë ekonomike apo me pagesë invaliditeti.

**Objektivi 2.3: Sigurimi i fondeve dhe mbështetjes institucionale përmes aplikimit për grante projektesh apo marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione dhe organizata partnere që ofrojnë mbështetje financiare, ndër të tjera, për zbatimin e programeve parandaluese dhe fuqizuese që mundësojnë punësueshmërinë, fuqizimin ekonomik, përfshirjen sociale dhe integrimin e individëve madhorë të familjeve rome dhe egjiptiane, familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, të rikthyera nga proceset azilkërkuese, viktima të dhunës, apo me aftësi të kufizuar por që janë të aftë për punë ose vetpunësim.**

**Aktivitetet:**

2.3.1 Përgatitja e projekt-fishave dhe aplikimi në skemat e financimit të qeverisë qëndrore në fushën e mbrojtjes sociale, punësimit, dhe strehimit për të gjitha kategoritë e përfshira në PVKPS.

- projekt-fisha për Fondin Social

- projekt-fisha për Fondin e Aftësimit dhe Punësimit

- projekt-fisha për Fondin e Strehimit Social

2.3.2 Krijimi i një hartëzimi / rrjeti për bashkëpunime me institucione dhe partnerë potencialë si BE, KiE, OSBE, agjenci të OKB-së ambasada të vendeve të zhvilluara në vendin tonë, etj.

2.3.3 Lidhja e marrëveshjeve dhe/ose komunikime të dakordësuara, kur është e mundur, me institucione të tjera shqiptare dhe/ose ndërkombëtare që sigurojnë mbështetje financiare dhe/ose institucionale me qëllim financimin/mbështetjen e shërbimeve sociale/programeve komunitare të Bashkisë Fier

2.3.4 Identifikimi i thirrjeve për projekte që ofrojnë mbështetje financiare me qëllim financimin e shërbimeve sociale dhe programeve komunitare të Bashkisë Fier.

2.3.5 Ideimi, hartimi dhe zbatimi i projekteve dhe nismave që synojnë punësueshmërine, përfshirjen sociale, dhe fuqizimin ekonomik të komuniteteve në nevojë të:

- familjeve rome dhe egjiptiane

- familjeve përfitues të ndihmës ekonomike

- individëve/familjeve të rikthyera nga proceset azilkërkuese

- individëve që kanë përfunduar kryerjen e dënimeve penale ose që janë nën masat e shmangies nga ndjekja penale

-individë me aftësi të kufizuara të aftë për punë

-viktima të dhunës në familje apo të trafikimit

2.3.6 Sigurimi i vijueshmërisë së mbështetjes financiare për familjet në nevojë dhe personat me aftësi të kufizuar (Ndihma Ekonomike
Aftësia e Kufizuar (PAK, Të verbrit, dhe Tetraplegjikë)

**Qëllimi 3: Përmirësimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional për raportimin, monitorimin dhe vlerësimin vjetor të 'Planit Vendor të Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale'**

**Objektivi 3.1**: **Zhvillimi i një strukture ndërinstitucionale koordinuese për zbatimin dhe monitorimin e Planit Vendor të Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale në Bashkinë Fier**

**Akitivitetet:**

3.1.1 Krijimi i një Komiteti Ndërinstitucional Drejtues për Planin Vendor i përbërë nga Zv. Kryetari i Bashkisë Fier, titullarët e institucioneve sektoriale përgjegjëse, dhe drejtuesit e organizatave partnere.

3.1.2 Organizimi nga Bashkia Fier i takimeve periodike të Komitetit Ndërinstitucional Drejtues të Planit Vendor, të mbajtura të paktën një herë në vit, me qëllim njohjen e problematikave ndërsektoriale dhe koordinimin e vendimeve për zgjidhjen e tyre.

3.1.3 Organizimi nga Bashkia Fier i takimeve të Grupit Teknik Ndërinstitucional i PVKPS së Bashkisë Fier për menaxhimin e rasteve të individëve, familjeve, dhe komuniteteve të përfshira në Planin Vendor, të mbajtura të paktën një herë në tre muaj.

3.1.4 Përgatitja dhe prezantimi i dokumentacionit dhe mjeteve të nevojshme për të siguruar mbështetjen financiare dhe burimet e nevojshem për zbatimin e Planit Vendor.

**Objektivi: 3.2: Realizimi i vlerësimit vjetor të Planit Vendor për të identifikuar arritjet, sfidat dhe mundësitë për përmirësim në ofrimin e shërbimeve sociale dhe përfshirjes së komunitetit.**

**Aktivitetet:**

3.2.1 Krijimi i një grupi pune ndërinstitucional me punonjës nga drejtoria e shërbimeve sociale, drejtoria e projekteve, drejtoria juridike (strehimi social), dhe drejtoria e financave në bashki si dhe institucionet bashkëpërgjegjëse (Pikat Fokale për çdo institucion) për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave lidhur me zbatimin e Planit Vendor

3.2.2 Mbledhja e të dhënave dhe informacioneve mbi treguesit e zbatimit të Planit Vendor, duke përfshirë analizën e statistikave dhe raportet nga strukturat përgjegjëse.

3.2.3 Organizimi i një sesioni vlerësues me pjesëmarrjen e personelit të shërbimeve sociale, përfaqësuesve komunitarë dhe përfaqësues të organizatave partnere për të diskutuar rezultatet dhe gjetjet e vlerësimit.

3.2.4 Hartimi i një raporti vjetor të vlerësimit të Planit Vendor, duke përfshirë rekomandime për të përmirësuar efektivitetin dhe impaktin e shërbimeve sociale në Bashkinë Fier (përgatitet nga Grupi Teknik Ndërinstitucional për Komitetin Ndërsektorial Drejtues)

3.2.5 Shpërndarja e materialeve relevante që dokumentojnë punën për zbatimin e PVKPS -së në webfaqen e bashkisë dhe përmes mediumeve të tjera të komunikimit (media sociale, media tradicionale etj.).

# 4.MONITORIMI DHE ZBATIMI

## 4.1 Treguesit e Monitorimit

*Grupi Ndërinstitucional i Punës* për zbatimin e PVKPS-së i përbërë nga ekspertë të fushave të ndryshme nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Projekteve, Drejtoria e Financave, Qendra e Ndihmës Ligjore Falas, Drejtoria Rajonale e Shërbimeve Sociale, Zyra Arsimore, Zyra e Punës, Drejtoria e Shëndetit Publik, Prefektura, si dhe përfaqësues të organizatave të specializuara dhe komunitare që operojnë në territorin e Bashkisë Fier ka përgjegjësi të rëndësishme. Këtu janë disa nga detyrat dhe përgjegjësitë që ka Grupi Ndwrinstitucional i Punws.

1. **Mbledhja dhe dërgimi i të dhënave**: Grupi Ndërinstitucional i Punës ka përgjegjësi për të mbledhur dhe dërguar të dhëna relevante për zbatimin e PVKPS. Kjo përfshin informacione të ndryshme nga departamentet dhe entet e përfshira në grup.

2. **Kontributi në hartimin e raporteve vjetore**: Grupi Ndërinstitucional i Punës kontribuon në hartimin e raporteve vjetore të progresit të PVKPS. Këto raporte do të përmbajnë analizën e treguesve të nivelit të qëllimeve dhe të aktiviteteve të planit.

3. **Paraqitja dhe miratimi i raporteve**: Raportet vjetore të hartuara nga Grupi Ndërinstitucional i Punës paraqiten për miratim në *Komitetin Drejtues Ndërinstitucional,* i përbërë nga titullarët e institucioneve pjesëmarrëse dhe i koordinuar nga Zv.Kryetari i Bashkisë Fier. Kjo siguron që të gjitha palët e interesuara në zbatimin e PVKPS kanë informacion të plotë dhe transparent për progresin dhe sfidat e identifikuara.

4. **Monitorimi dhe vlerësimi i planit në vazhdimësi:** Grupi Ndërinstitucional ka detyrën të monitorojë zbatimin e PVKPS bazuar në treguesit e nivelit të qëllimeve dhe aktiviteteve të përcaktuara në plan. Ky monitorim siguron që Bashkia Fier të ketë një vlerësim objektiv të performancës dhe të arrijë synimet e vendosura.

5. **Bashkëpunimi dhe koordinimi institucional**: Pjesë e përgjegjësive të grupit është sigurimi i bashkëpunimit dhe koordinimit efektiv mes të gjitha strukturave dhe organizatave të përfshira, për të siguruar një zbatim sa më efikas dhe të koordinuar të PVKPS.

Këto pika tregojnë rolin kyç të Grupit Ndërinstitucional të Punës dhe Komitetit Drejtues Ndërinstitucional në zbatimin dhe monitorimin e vlerësimin e Planit Vendor të Kujdesit dhe Përshirjes Sociale në Bashkinë Fier. Monitorimi i këtij Plani do të kryhet bazuar në treguesit në nivel qëllimesh dhe në treguesit dhe synimet në nivel aktivitetesh, të cilat paraqiten më poshtë.

### 4.1.1 Treguesit e monitorimit në nivel qëllimesh

**Treguesit për ngritjen e strukturave dhe fuqizimin e kapaciteteve institucionale, sipas qëllimit nr. 1**

1. Niveli i përmirësimit të aftësive të personelit të shërbimeve sociale
2. Numri i stafit të trajnuar dhe larmishmëria e programeve të trajnimit të zhvilluara çdo vit për punonjësit e vjetër dhe të rinj të shërbimeve sociale
3. Vlerësimi vjetor i performancës së personelit të shërbimeve sociale nga kategoritë e përfituesëve dhe strukturat përgjegjëse

**Treguesit për financimin dhe efikasitetin e shërbimeve dhe programet, sipas qëllimit nr. 2**

1. Numri dhe shumëllojshmëria e shërbimeve të kujdesit dhe përfshirjes sociale të ofruara në territorin e Bashkisë Fier
2. Niveli i përfshirjes së të gjitha kategorive në nevojë të identifikuara në PVKPS në programet parandaluese dhe fuqizuese të ofruara
3. Efikasiteti i kombinimit të *shërbimeve sociale* me *programet për fuqizimin e komunitetit* në adresimin e nevojave të identifikuara në Bashkinë Fier

**Treguesit për nxitjen e bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile, sipas qëllimit nr. 3**

1. Niveli i pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit të institucioneve në procesin e koordinimit dhe monitorimit të PVKPS
2. Efektiviteti i vlerësimeve vjetore të Planit Vendor, përfshirë përcaktimin e pikave të forta dhe atyre të dobëta dhe rekomandimeve për përmirësim.

3. Ndikimi i masave të ndërmarra për përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në cilësinë dhe ofrimin e shërbimeve të PVKPS

### 4.1.2 Treguesit dhe synimet e kostuara në nivel aktivitetesh

**Treguesit dhe Synimet për Aktivitetet 1.1.1 – 1.1.3**

**1.1.1 Numri i pozicioneve të plotësuara në sektorin e Mbrojtjes dhe Përkujdesit Social** dhe **1 NJVNR e ngritur nw Bashki**

- Brenda vitit të parë, të plotësohen të gjitha pozicionet e planifikuara në sektorin e Mbrojtjes dhe Përkujdesit Social në nivel Bashkie. (Paga dhe sigurime, 1,050,000 ALL vit për 1 staf x 2 vite = 2,100,000 ALL.)

**1.1.2 Numri i NJVNR-ve të ngritura me staf të kualifikuar**.

- 13 NJVNR të ngritura dhe funksionale në 13 NJA, dhe të paktën 60% e NJVNR-ve të ngritura brenda vitit të dytë, të kenë staf të kualifikuar dhe me përvojë përkatëse. (Paga dhe sigurime, 4 staf për dy vite)

**1.1.3 Numri dhe përqindja e stafit në Bashki dhe NJA të pajisur me infrastructure te permiresuar pune çdo vit**.

- Brenda vitit të dytë, 80% e strukturës e pajisur me infrastrukturë të përshtatshme pune. (Lump sum 100,000 ALL x 13 në NJA + 6 në bashki = 1,900,000 ALL)

**Treguesit dhe Synimet për Aktivitetet 1.2.1 – 1.2.5**

**1.2.1 Numri i paketave orientuese të përgatitura dhe përditësuara çdo vit të shpërndara personelit që raportojnë njohuri të mjaftueshme nga paketa orientuese**.

- Brenda gjashtë muajve të parë, të përgatiten dhe të shpërndahen të paktën 2 paketa orientuese përkatësisht për drejtuesit dhe personelin e ri të strukturave të kujdesit dhe shërbimeve sociale, 90% e të cilëve raportojnë se paketa orientuese i ka ndihmuar të kuptojnë dhe të kryejnë më mirë rolin dhe detyrat e tyre. (Kosto printimi 120,000 ALL)

**1.2.2 Numri i vizitave studimore të organizuara dhe përqindja e pjesëmarrësve në to që raportojnë përfitime praktike nga këto vizita.**

- Brenda vitit të parë, të organizohen të paktën 2 vizita studimore në bashki me përvojë në fushën e shërbimeve sociale dhe programeve fuqizuese komunitare, me të paktën 5 pjesëmarrës për secilën vizitë dhe të paktën 80% e pjesëmarrësve raportojnë se këto vizita kanë kontribuar në përmirësimin e praktikave të tyre të punës. (Akomodim/transport/dieta 20,000 ALL person për 2 takime x 5 persona = 200,000 ALL.)

**1.2.3 Numri i trajnimeve të organizuara dhe përqindja e pjesëmarrësve në to që raportojnë përmirësim në kuptimin e kuadrit ligjor dhe praktikave të punës pas trajnimit**.

- Brenda vitit të parë, të organizohen të paktën 3 trajnime në vit për stafin e Sektorit të Mbrojtjes dhe Përkujdesjes Sociale në Bashki mbi kuadrin ligjor, praktikat e punës dhe marrëdhëniet me

publikun, me të paktën 15 pjesëmarrës në secilin trajnim dhe të paktën 80% e pjesëmarrësve të raportojnë një përmirësim të dukshëm në kuptimin e kuadrit ligjor dhe praktikave të punës pas trajnimit. (Kosto transporti/dieta 2000 ALL x 15 staf x 3 trajnime x 2 vite = 180,000 ALL)

**1.2.4 Numri i trajnimeve të organizuara dhe pjesëmarrësve në to që raportojnë përmirësim në menaxhimin e koordinuar të rasteve pas trajnimit.**

- Brenda vitit të parë, të organizohen të paktën 3 trajnime për ekipet që menaxhojnë rastet sociale mbi menaxhimin e koordinuar të rasteve, me të paktën 4 pjesëmarrës për secilin trajnim dhe të paktën 80 % e rasteve sociale të menaxhohen në mënyrë të koordinuar pas trajnimeve. (Kosto transporti/dieta 2000 ALL x 4 staf x 3 trajnime x 2 vite = 48, 000 ALL)

**1.2.5 Numri i trajnimeve të organizuara dhe pjesëmarrësve në to që raportojnë përmirësim në fushën e hartim-zbatim-vlerësim projektesh dhe ngritje fondesh.**

- Brenda vitit të parë, të organizohen të paktën 3 trajnime për stafin e Sektorit Përgjegjës në fushën e hartimit, zbatimit dhe vlerësimit të projekteve dhe ngritjen e fondeve, me të paktën 6 pjesëmarrës për secilin trajnim, dhe brenda vitit të parë, të hartohen dhe të zbatohen me sukses të paktën 3 projekte të reja nga stafi i trajnuar. (Kosto transporti/dieta 2000 ALL x 6 staf x 3 trajnime x 2 vite = 72,000 ALL)

**Treguesit dhe Synimet për Aktivitetet 2.1.1 – 2.1.5**

**2.1.1 Numri i materiale informuese të shpërndara dhe përqindja e qytetarëve që raportojnë se kanë marrë informacion mbi ekzistencën dhe mënyrat e aksesimit të shërbimeve dhe programeve sociale**.

- Brenda vitit të parë, të shpërndahen të paktën 1,000 materiale informuese (broshura, fletëpalosje, postera) mbi shërbimet dhe programet ekzistuese dhe mënyrat e aksesimit të tyre, dhe brenda vitit të dytë, të paktën 70% e qytetarëve të anketuar duhet të raportojnë se kanë marrë informacion mbi shërbimet dhe programet përmes këtyre materialeve informuese. (Dizenjim dhe printim 200 ALL x 1000 copë = 200,000 ALL)

**2.1.2 Frekuenca e përditësimit të webfaqes së Bashkisë dhe përqindja e përmbajtjes së përditësuar që mbulon shërbimet e kujdesit social**.

Seksioni mbi mbrojtjen sociale në webfaqen e Bashkisë duhet të përditësohet të paktën një herë tre muaj me informacion të ri dhe të saktë, dhe brenda vitit të parë, të paktën 80% e përmbajtjes në këtë seksion duhet të jetë e përditësuar dhe e saktë. (Dy herë në vit përditësim/video/podcast 100,000 ALL)

**2.1.3 Numri i panaireve të organizuara dhe pjesëmarrësve që marrin ndihmë të drejtëpërdrejtë në to.**

- Të paktën 2 panaire me nga 100 pjesëmarrës në secilin panair nga të cilët të paktën 60% marrin ndihmë të drejtëpërdrejtë për aksesimin e shërbimeve. (Lump sum 500,000 ALL x 2 panaire = 1,000,000 ALL)

**2.1.4 Numri i trajnimeve të organizuara për ndërlidhësit komunitar dhe kryetarët e fshatrave dhe përqindja që raporton njohuri mbi identifikimin dhe referimin e rasteve**.

- Të paktën 13 të trajnuar brenda vitit të parë, nga të cilët të paktën 80% raportojnë përmirëm të njohurive për identifikimin dhe referimin e rasteve në nevojë për shërbime. (Kosto transporti/dieta 2000 ALL x 13 staf x 1 trajnim x 2 vite = 52,000 ALL)

**2.1.5 Numri i individëve që marrin ndihmë ligjore parësore dhe dytësore çdo vit.**

- Të paktën 120 individë përfitojnë brenda vitit të parë, nga të cilët të paktën 80% raportojnë se kanë marrë asistencë e plotë në përgatitjen e dokumentacionit dhe/ose akses në shërbimet e digjitalizuara pas marrjes së ndihmës ligjore. (Pa kosto)

**Treguesit dhe synimet për aktivitetet 2.2.1-2.2.10**

**2.2.1 Nje qender komunitare ne Fier-Banesat Sociale me shërbime dhe programe të përmirësuara dhe të zgjeruara sipas synimeve të mëposhtme**:

- Numri i prindërve që marrin pjesë në sesionet mujore të këshillimit për prindërimin e mirë do të rritet me 20% brenda vitit të parë.
- Numri i nxënësve të arsimit të detyruar të regjistruar dhe të përfshirë në programet mbështetëse pas-shkolle duhet të arrijë të paktën në 50 brenda gjashtë muajve të parë.
- 75% e të rinjve që marrin pjesë në programet mbi aftësimin jetësor duhet të raportojnë përmirësim në aftësitë e tyre të jetës brenda vitit të parë.
- Të ofrohet ndihmë ligjore falas për të paktën 10 individë në muaj ose 120 në vit për të aksesuar shërbimet në e-albania.
- Numri i të rinjve dhe familjeve që marrin këshillim kariere dhe punësimi duhet të arrijë të paktën në 50 brenda vitit të parë të zbatimit dhe të paktën 150 në total
- Numri i personave që marrin këshillim psikosocial të personalizuar duhet të arrijë të paktën në 50 brenda vitit të pare dhe të paktën 150 në total.
- Të ofrohen shërbime në familje për të paktën 50 persona me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm brenda vitit të pare dhe të paktën 150 në total

(24,705,000 ALL projekti aktual i Fondit Social për 36 muaj)

**2.2.2 Numri i fëmijëve pa kujdes prindëror të identifikuar, referuar dhe** që përfitojnë kujdestari ligjore në familje kujdestare

- Të paktën 40 fëmijë në vit përfitojnë kujdestari ligjore në familje kujdestare. (9,000 ALL për fëmijë në muaj x 12 muaj x 2 vite, 8,640,000 ALL; + 25,000 ALL për shpenzime shkollore në vit x 2 vite x 40 fëmijë = 10,910,000 ALL)

**2.2.3 Numri i fëmijëve viktima të trafikimit dhe/ose pa kujdes prindëror të identifikuar, referuar dhe shoqëruar tek qendrat rezidenciale në rrethe të tjera**

- Të paktën 15 fëmijë në vit referohen në qendrat rezidenciale në rrethe të tjera.
  (Transport/ushqim për rast 5000 ALL x 15 fëmijë në vit x 2 vite = 150,000 ALL)

**2.2.4 Numri i qendrave që ofrojnë strehim emergjent 72 orësh për viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët.**

- Brenda vitit të dytë, të ngrihet dhe të jetë funksionale të paktën një qendër ku të strehohen të paktën 20 viktima të dhunës në familje në shërbimin e emergjencës 72 orë (Pa kosto për bashkinë)

•

**2.2.5 Numri i shërbimeve të reja dhe numri i të moshuarve që përfitojnë pranë qëndres ditore dhe në familje.**

- *Shtimi dhe përmirësimi i ambjenteve të Shtëpisë së të Moshuarave në Fier* (Ambjentet në proces nga donator)

- *Shtimi dhe trajnimi i sfafit të Shtëpisë së të Moshuarve* (2 staf mbështetës nga bashkia për dy vite = 2,874,000 ALL)

- *Ngritja e shërbimeve ditore (kafe/çaj, internet, gazeta për të paktën 40 të moshuar) pranë Qendrës Ditore për moshuarit e tretë* (kafe/çaj lump sum për 40 të moshuar = 3,000,000 ALL)

- *Shërbime në familje (kryerja e blerjeve javore, shërbim infermieror, shërbim higjeno-sanitar) për të moshuarit e vetmuar (*Transport/shpërblim /pako higjeno-sanitare *lump sum* 5000 ALL x 40 të moshuar për dy vite, = 400,000 ALL)

Totali për 2.2.5 për dy vite: 6,274,000 ALL

**2.2.6 Numri i përfituesëve dhe vijueshmëria e përmirësimi i shërbimeve për personat me aftësi ndryshe në Qendrën Horizont.**

- *Shërbimi ditor për fëmijët me aftësi ndryshe 6 – 21 vjeç*
- *Shtimi i stafit të kualifikuar*
- *Shërbime shtesë të integruara në fushën e arsimit dhe punësimit (për moshën 19-21 vjeç)*

Totali për 2.2.6 për dy vite: 27,154,000 ALL x 2 vite = 54,308,000 ALL

**2.2.7 Numri i përfituesëve që marrin shërbime ligjore falas dhe përqindja e tyre që raportojnë zgjidhje të sukseshme të çështjeve ligjore pas marrjes së shërbimeve**.

Të paktën 120 individë të përfitojnë nga shërbimet ligjore falas çdo vit, nga të cilët të paktën 70% raportojnë zgjidhje të sukseshme të çështjeve ligjore pas marrjes së shërbimeve. (Pa kosto për bashkinë)

**2.2.8 Numri i rasteve të referuar dhe ndjekur pranë Qendrës së Emergjencës për Viktimat e Mitur të Dhunës Seksuale çdo vit**.

- Të gjitha rastet e identifikuara dhe të paktën 80% e viktimave të mitur marrin ndihmë të mjaftueshme dhe të dobishme pas shërbimeve të ofrura. (Transport/telefon/ushqim/veshmbathje etj. 5000 ALL x 20 fëmijë x 2 vite = 200,000 ALL)

**2.2.9 Numri i rasteve të referuar dhe ndjekur pranë Spitalit Rajonal Fier për probleme të shëndetit mendor dhe varësisë nga alkooli dhe droga**.

- Të gjitha rastet e identifikuara dhe të paktën 80% e pacientëve marrin ndihmë të mjaftueshme dhe të dobishme pas shërbimeve të ofruara. (Transport/telefon/ushqim/veshmbathje etj. 5000 ALL x 20 persona nën varësi x 2 vite = 200,000 ALL)

**2.2.10 Numri i rampave të ndërtuara ose përmirësuara dhe përqindja e institucioneve publike dhe transportit publik që kanë rampa të aksesueshme**.

- Brenda vitit të dytë të ndërtohen të paktën 20 rampa dhe brenda vitit të tretë 80% e institucioneve publike dhe transportit publik të kenë rampa të aksesueshme. (Ramp 200,000 ALL x 20 rampa = 4,000,000 ALL)

**2.2.11 Numri i rasteve të trajtimit me bonus qiraje, banesë sociale ose lehtësimi i procedurave për rikonstruksion banese për familjet rome/egjiptiane, familjet në nevojë të rikthyer nga emigracioni i pasuksesshëm, dhe familjet në ndihmë ekonomike apo me pagesë invaliditeti**.

- Të paktën për 50 raste brenda një viti (Sipas Planit Vendor të Strehimit Social)

**Treguesit dhe synimet për aktivitetet 2.3.1 – 2.3.5**

**2.3.1 Numri i projekt-fishave të përgatitura, aplikuar dhe të financuara nga qeveria qendrore në fushën e mbrojtjes sociale, punësimit dhe strehimit për të gjitha kategoritë e përfshira në PVKPS.**

- Brenda vitit të parë, të përgatiten dhe të aplikohen të paktën 2 projekt-fishe në fushën e mbrojtjes sociale, punësimit, dhe strehimit për të gjitha kategoritë e përfshira në PVKPS. (Lump sum për ekspert/ë për totalin e projekt-fisheve 200,000 ALL)

**2.3.2 Numri i institucioneve dhe partnereve të përfshirë në hartëzim/rrjetin e krijuar**.

- Të paktën dhjetë institucione dhe partnerë potencialë përfshihen në databazën e hartëzimit. (, 120,000 ALL x 2 vite = 240,000 ALL)

**2.3.3 Numri i marrëveshje dhe/dakordësimeve me institucionet dhe partenerët e përfshirë në databazën e hartëzimit për financim apo mbështejte të shërbimeve sociale ose programeve komunitare tëBashkisë Fier**.

Të paktën 3 marrëveshje/dakordësime me institucione dhe partnerë potencialë të arrihen brenda vitit të dytë. (Pa kosto për bashkinë Fier)

**2.3.4 Numri i thirrjeve për projekte të identifikuara dhe analizuara**.

- Të paktën 4 thirrje për projekte dhe të paktën 1 për secilin target grup që ofrojnë mbështetje financiare për financimin e shërbimeve sociale dhe programeve komunitare të Bashkisë Fier të identifikohen dhe analizohen çdo vit. (Pa kosto për bashkinë Fier)

**2.3.5 Numri i projekteve dhe nismave** që synojnë punësueshmërine, përfshirjen sociale, dhe fuqizimin ekonomik të komuniteteve në nevojë të aplikuara dhe zbatuara për secilën kategori:

- familjeve rome dhe egjiptiane

- familjeve përfitues të ndihmës ekonomike

- individëve/familjeve të rikthyera nga proceset azilkërkuese

- individëve që kanë përfunduar kryerjen e dënimeve penale ose te mitur qe po procedohen penalisht

- 

- Të hartohen dhe të paraqiten të paktën 3 projekt-propozime (të paktën 1 për secilin target grup) çdo vit tek donatorët e mundshëm që synojnë punësueshmërinë, përfshirjen sociale dhe fuqizimin ekonomik të komuniteteve në nevojë. (15,000,000 ALL për 100 përfitues x 2 vite = 30,000,000 ALL)

**2.3.6 Sigurimi i vijueshmërisë së mbështetje financiare për familjet në nevojë dhe personat me aftësi të kufizuar**

- Ndihma Ekonomike, Aftësia e Kufizuar (PAK, Të verbrit, dhe Tetraplegjikë) përllogaritur për dy vite = 926,300,000 ALL

**Treguesit dhe synimet për aktivitetet 3.1.1 – 3.1.4**

**3.1.1 Komiteti Ndërinstitucional Drejtues për Planin Vendor duhet të mblidhet dhe të jetë funksional brenda 3 muajve nga miratimi i Planit**.

- Brenda 3 mujave nga miratimi, titullarët e institucioneve pjesëmarrëse duhet të kenë zhvilluar mbledhjen e parë dhe të kënë caktuar Pikat Fokale për Grupin Teknik Ndërinstitucinal të PVKPSsë. (Pa kosto)

**3.1.2 Numri i takimeve të Komitetit Ndërinstitucional Drejtues të mbajtura dhe dokumentuara çdo vit**.

- Të paktën një takim vjetor i Komitetit Ndërinstitucional Drejtues duhet të organizohet dhe të domumentohet në raportin e mbledhjeve të Komitetit. (Pa kosto)

**3.1.3 Numri i takimeve të Grupit Ndërsektorial i Punës mbi zbatimin e PVKPS të mbajtura dhe dokumentuara çdo tremujor.**

- Të paktën katër takime tremujore të dokumentuara në raportet tre mujore të progresit të Planit Vendor. (Pa kosto)

**3.1.4 Sigurimi i dokumentacionit dhe burimeve për zbatimin e planit brenda afatit të përcaktuar**.

Të përgatitet dhe të prezantohet dokumentacioni i nevojshëm për të siguruar mbështetjen financiare dhe burimet për zbatimin e planit brenda 6 muajve nga miratimi i tij. ( Lump sum në total 50,000 ALL)

- 

•

**Treguesit dhe synimet për aktivitetet 3.2.1 – 3.2.5**

**3.2.1 Krijimi dhe funksionimi i Grupit Ndërinstitucional të Punës për mbledhjen dhe përpunimin e statisktikave lidhur me zbatimin e Planit** me punonjës nga drejtoria e shërbimeve sociale, drejtoria e projekteve, drejtoria juridike (strehimi social), dhe drejtoria e financave në bashki si dhe institucionet bashkëpërgjegjëse (Pikat Fokale për çdo institucion).

- Brenda muajit të parë nga miratimi i Planit të gjithë sektorët në Bashki dhe institucionet e përfshira duhet të kenë përfaqësues të tyre në grupin punues për të siguruar informacionin e nevojshëm dhe bashkëpunimin e plotë. (Pa kosto)

**3.2.2 Frekuenca e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për treguesit e zbatimit të Planit Vendor, si dhe përgatitja dhe shpërndarja e analizave dhe raporteve përkatëse**.

- Të dhënat dhe informacionet për treguesit e zbatimit të Planit Vendor duhet të mbledhen dhe të përpunohen në bazë tremujore. (Pa kosto)

**3.2.3 Frekuenca e organizimit të sesionit vlerësues dhe sigurimi i pjesëmarrjes së pjesëtarëve të interesuar për të diskutuar dhe vlerësuar rezultatet e implementimit të planit**.

- Sesioni vlerësues duhet të organizohet dhe të mbahet në fund të çdo viti për të diskutuar dhe vlerësuar rezultatet vjetore të zbatimit të Planit me pjesëmarrjen e strukturave të shërbimeve sociale, përfaqësuesve të komunitarë dhe institucioneve e organizatave partnere. (Lump sum në total, 15,000 ALL)

**3.2.4 Hartimi dhe prezantimi i raportit vjetor të vlerësimit për shërbimet sociale në bashki, duke përfshirë rekomandimet për të përmirësuar efikasitetin, efektivitetin dhe impaktin e masave të parashikuara**.

- Raporti vjetor i vlerësimit duhet të hartohet dhe të prezantohet në fillim të vitit të ri për të pasqyruar rezultatet dhe rekomandime specifike mbi masat që duhet ndërmarrë në vijimësi. (Editim, dezinjim, printim 120,000 ALL për raport x 2 raporte vjetore = 240,000 ALL)

**3.2.5 Frekuenca e publikimit dhe shpërndarjes në faqen e Bashkisë dhe në media të tjera të komunikimit të materialeve relevante për zbatimin e PVKPS-së**.

- Të sigurohet që materialet të jenë të aksesueshme/të qasshme dhe të kuptueshme për publikun dhe të ndahen në mënyrë transparente për të gjithë qytetarët në bazë tremujore (Pa kosto)

## 4.2 Risqet e zbatimit

Risqet dhe masat e mundshme për secilin qëllim janë si vijon:

**Qëllimi 1: Rritja e kapaciteteve institucionale të strukturave përgjegjëse**

**Risqet:**

1. Mungesa e financimit për rekrutimin dhe/ose trajnimin e stafit dhe zhvillimin e kapaciteteve.
2. Mungesa e përkushtimit nga stafi për të përdorur dhe zbatuar njohuritë e fituara në trajnime.

•

**Masat e Mundshme:**

1. Sigurimi i burimeve financiare për rekrutimin dhe/ose trajnimin e vazhdueshëm të stafit në fushën e menaxhimit dhe zhvillimit institucional.
2. Krijimi i një kulture organizative që promovon përdorimin dhe zbatimin e njohurive të fituara në trajnime, përmes incentivave dhe mbikqyrjes së performancës.

**Qëllimi 2: Përmirësimi i financimit dhe efikasitetit të shërbimeve sociale dhe programeve të fuqizimit komunitar**

**Risqet:**

1. Mungesa e burimeve financiare për të mbështetur programe specifike për grupet në nevojë
2. Një proces i komplikuar dhe i ngadalshëm për aplikimin dhe shpërndarjen e fondeve për shërbime sociale dhe programe për fuqizim komuniteti **Masat e Mundshme:**

1. Identifikimi dhe sigurimi i burimeve alternative për të shtuar financimin e programeve komunitare, përmes partneritetit me organizata jofitimprurëse dhe sektorin privat

2. Rishikimi i procedurave administrative për aplikimin dhe shpërndarjen e fondeve për të zvogëluar burokracinë dhe për të lehtësuar aksesin e komunitetit në fondet e disponueshme

**Qëllimi 3: Shtimi i bashkëpunimit ndërinstitucional me institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile**

**Risqet**

1. Mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit efektiv mes institucioneve dhe organizatave jofitimprurëse
2. Konflikte të mundshme të interesave midis aktorëve të ndryshëm **Masat e Mundshme:**

1. Krijimi i një platforme të përbashkët për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e aktiviteteve ndërinstitucionale dhe ndërmjet institucioneve dhe organizatave jofitimprurëse.

2. Zbatim i standardeve të qarta etike dhe transparente për të parandaluar konflikte të interesave dhe për të siguruar që bashkëpunimi të jetë i qëndrueshëm dhe i frytshëm në të ardhmen.

Duke ndërmarrë këto masa, Bashkia synon të zvogëlojë riskun dhe të përmirësojë efikasitetin e përgjithshëm të veprimtarisë së saj në fushën e kujdesit dhe përfshirjes sociale.

Referencat

**Korniza Ligjore**

- Ligji Nr. 121/2016 Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror.
- Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore."

- Ligj Nr. 111/2017 Për ndihmën juridike të garantuar nga shtetit, dhe VKM-të zbatuese; Ligj Nr. 22/2018 Për strehimin social, (i ndryshuar) dhe VKM-të zbatuese.
- Ligj Nr. 15/2019 Për nxitjen e punësimit.
